

«Të murosur»

Jeta nën diktaturë dhe mungesa e lirisë



Përmbledhje e materialeve të konferencës "Muri dhe mungesa e lirisë"

Tiranë 2011

Përmbajtja

Willibold Frehner

Parathënie dhe hyrje në tematikë

Rainer Eppelmann

Mbi vlerat e lirisë – jetën në diktaturë dhe demokraci

Ulrich Mähler

Muri i Berlinit dhe kufiri ndërgjerman – instrumente të sigurimit të sundimit të Partisë së Bashkuar Socialiste të Gjermanisë (SED)

Anna Kaminsky

Muri i Berlinit në botë

Pandeli Pani

Diktatura në Shqipëri, veçoritë dhe anët e përbashkëta me diktaturat e tjera dhe regjimet totalitare

Pranvera Bektashi

Shpirti dhe shteti totalitar

Artan Puto

Përballja me të kaluarën dhe hapja apo mbyllja e dosjeve në Shqipërinë postkomuniste

Parathënie

Gushti i vitit 2011 shënoi përvjetorin e pesëdhjetë të ngritjes së Murit të Berlinit. 13 gushti 1961 ka hyrë në histori si data e ndërtimit të Murit. Fondacioni Konrad Adenauer e mori këtë ngjarje si shkas për të zhvilluar në Tiranë një konferencës me titullin "Muri dhe mungesa e lirisë". Ky ishte një nga aktivitetet e organizuara nga fondacioni Konrad Adenauer në Shqipëri rreth temës "Mungesa e lirisë dhe diktatura komuniste".

Sikurse dihet në pjesën lindore të Gjermanisë sundoi pas Luftës së Dytë Botërore për shumë vite një diktaturë komuniste. Kjo pati pasoja negative dhe ndikim të thellë ndaj qytetarëve dhe çimentoj gjithashtu për një kohë të gjatë ndarjen e Gjermanisë.

Por diktatura komuniste nuk ishte instaluar vetëm në Gjermani, por në një varg të tërë vendesh të Evropës së sotme Qendrore dhe Lindore. Edhe Shqipëria përjetoi një diktaturë komuniste brutale, efektet e së cilës vazhdojnë të kenë ndikim ende deri sot në çdo familje shqiptare si dhe në pjesë të shoqërisë dhe të politikës.

Përballja me diktaturën komuniste në Shqipëri sapo ka filluar. Studimi objektiv i krimeve dhe përballja me historinë komuniste, kanë një rëndësi të madhe për konsolidimin e sundimit të ligjit dhe zhvillimin demokratik të vendit. Në organet më të larta të politikës dhe të shkencës vazhdon të ketë ende figura të larta, që ishin pjesë e regjimit të dikurshëm komunist. Ende ka të përndjekur politikë që nuk janë rehabilituar akoma, edhe pse deri tani janë bërë disa pagesa të para kompensimesh dhe dëmshpërblimesh.

Fondacioni ynë Konrad Adenauer organizon seminare të tilla, të cilat i konsiderojmë si hapa të rëndësishëm për përballjen dhe analizën e së kaluarës. Ne mendojmë se është e rëndësishme që ekspertët të shkëmbejnë me njëri-tjetrin mendime dhe të informohen se si mund të analizohet e kaluara, si mund të kapërcehet ajo dhe çfarë mësimesh mund të nxjerrë secili vend nga e kaluara.

Nëpërmjet studimit të shkaqeve, të rrjedhës dhe të pasojave të diktaturave komuniste në Gjermani dhe në Shqipëri, Shqipëria mund të përgatitet për përballjen dhe analizimin e së kaluarës komuniste dhe diktatoriale si dhe për t'i zhvilluar dhe çuar përpara strukturat e shtetit të së drejtës.

Ne si fondacion Konrad Adenauer jemi të bindur, se në qoftë se në Shqipëri nuk do të analizohet dhe hulumtohet e kaluara, në Shqipëri nuk mund të ndërtohet shteti i së drejtës ngaqë ky do të ngrihej mbi bazat e një padrejtësie që vazhdon të ekzistojë.

Në këtë seminar të rëndësishëm në Tiranë si dhe në diskutimet e mëtejshme morën pjesë këta ekspertë nga Gjermania:

- **Zoti Rainer Eppelmann**, aktivist i të drejtave të njeriut në RDGJ, ministër për Çarmatimin dhe Mbrojtjen në qeverinë e fundit të RDGJ-së, ish-deputet i CDU-së dhe anëtar i Komisionit Parlamentar të Bundestagut gjerman për Përballjen me shkaqet dhe pasojat e diktaturës së partisë komuniste të RDGJ-së, SED, Kryetar i kryesisë së Fondacionit federal për Përballjen me diktaturën e SED-së;
- **Zonja Dr. Anna Kaminsky**, Drejtore ekzekutive e Fondacionit federal për Përballjen me diktaturën e SED-së;
- **Zoti Dr. Ulrich Mähler**, ekspert për përballjen dhe analizën e së kaluarës komuniste; Drejtues i sektorit shkencor pranë Fondacionit federal për Përballjen me diktaturën e SED-së;
- **Zoti Dr. Pandeli Pani**, redaktor pranë Deutsche Welle dhe docent në Universitetin e Jenës dhe në Berlin, ekspert për vendet e Evropës Juglindore.

Unë dua t'i falënderoj përzemërsisht këta ekspertë për referatet e rëndësishme në seminar si dhe për ndihmën dhe kontributin që dhanë për çështje të ndryshme gjatë hartimit të projektligjit të ri për lustrimin.

Krahas ekspertëve nga Gjermania seminarin e pasuruan me kontributet e tyre edhe dy referentë shqiptarë, zonja Dr. Pranvera Bekteshi dhe zoti Dr. Artan Puto nga CEAPALNET.

Dr. Willibold Frehner

Mbi vlerat e lirisë – jetën në diktaturë dhe demokraci

Rainer Eppelmann

Për fat të mirë, në ditët e sotme shumë njerëz e kanë të pamundur të përfytyrojnë, se para 22 vjetësh Evropën dhe botën i ndante një “perde e hekurt” dhe e padepërtueshme.

Por brezi i kaluar i ka ende të qarta kujtimet për familjet që u ndanë për dekada me radhë, njerëzit që u qëlluan për vdekje gjatë tentativave të tyre për t’i shpëtuar komunizmit në përpjekje për të kaluar murin prej mijëra kilometrash të gjatë që ndante kufirin gjermano-gjerman.

Të gjitha vendet nën sundimin komunist kanë pasur viktime të shumta në këtë regjim. Por ne nuk na bashkon vetëm kujtimi për krimet e së shkuarës dhe viktimat e tyre. Ne na bashkon edhe kujtimi për dashurinë për liri dhe për ata njerëz, të cilët me gjithë represionet gjetën guxim dhe kurajë të kundërshtonin me protesta të hapura dhe të rrezikonin jetën dhe shëndetin e tyre, të familjeve të tyre apo edhe të ardhmen e fëmijëve të tyre.

Në vitin 2011 u mbushën 50 vjet nga koha e ndërtimit të murit në Gjermani. Në datën 13 gusht 1961 drejtuesit komunistë të RDGJ-së e rrethuan me mur popullatën e saj pothuajse brenda natës. Ata e mbyllën edhe vrimën e fundit nga ku mund të kalohej për në Perëndim – në Berlinin Perëndimor.

Kjo ngjarje dramatike la gjurmët e veta në jetën e miliona njerëzve në Lindje dhe në Perëndim. Ajo nuk vulosi përfundimisht vetëm ndarjen e botës për 28 vjet me radhë, por edhe ndau familjet nga njëra-tjetra dhe shkatërroi shpresat dhe jetën.

Duke kujtuar ndërtimin e murit më 13 gusht 1961, nuk na vijnë parasysh vetëm pamjet dramatike të ndërtimit të kufirit më të rrezikshëm në botë. Para sysh na vijnë edhe ngjarjet e datës 9 shtator 1989, kur muri, ashtu siç u ndërtua në mënyrë të papritur, brenda natës, po ashtu edhe u rrëzua brenda natës dhe duke e humbur edhe efektin e tij tmerrues. E kujt nuk i kujtohen pamjet me njerëzit që kërcenin mbi mur?

Por neve na kujtohet edhe një ngjarje tjetër, që ka ndodhur rreth 60 vjet më parë. Kjo sepse kush dëshiron të kuptojë revolucionin tonë të vitit 1989 dhe nuk ka jetuar vetë asnjëherë nën

diktaturën e SED-së (Partia Socialiste të Bashkuar të Gjermanisë Lindore) apo të ndonjë diktature tjetër komuniste, ai duhet të mësojë edhe për traumat, që kanë pësuar shumë qytetarë gjatë katër dekadave dhe kanë lënë gjurmë të thella brenda nesh.

Trauma e parë e rëndë ndodhi 58 vite më parë: E kam fjalën për ngjarjen tragjike të datës 15 qershor 1953, ditën e kryengritjes popullore në RDGJ. Kjo kryengritje ishte lëvizja e parë e madhe pas Luftës së Dytë Botërore dhe krijimit të diktaturës komuniste në Evropën Qendrore dhe Lindore kundër sundimit komunist. Në atë periudhë në mbi 600 qytete të RDGJ-së dolën në rrugë më shumë se një milionë njerëz për të protestuar kundër sundimit komunist, për zgjedhje të lira dhe një Gjermani të lidhur ngushtësisht. Fillesën e tyre e përbënë protestat kundër rritjes së pajustificuar të normave të punës dhe situata e keqe e furnizimit në Lindje.

Vetëm në qendër të Berlinit Lindor u mbledhën në atë periudhë më shumë se njëqind mijë vetë për të kërkuar dorëheqjen e qeverisë dhe zgjedhje të lira. Policia popullore ishte duke u tërhequr gjerësisht, demonstruesit kishin marrë flamurin e kuq sovjetik tek Porta e Brandenburgut dhe mësynë drejt zyrave qendrore të Qeverisë. Por në këtë moment, kur diktatura e SED-së ishte rrëzuar de facto, ndërhyne forcat pushtuese sovjetike dhe u dhanë urdhër tankeve të tyre për të ndërhyrë.

Demonstruesit hodhën gurë kundër kolosëve prej çeliku si dhe bashkuan krahët me njëritjetrin duke shtërnguar radhët, për të shkuar tek tanket dhe për t'i ndaluar ata – një luftë e pabarabartë, fati i së cilës ishte përcaktuar qysh në fillim. Në mbrëmje, kjo kryengritje popullore, e para në zonën sovjetike që pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, u shtyp në mënyrë të përgjakshme.

Zonja dhe zotërinj, kryengritja popullore e datës 17 qershor 1953 ishte një shpërthim spontan i zemërimit të njerëzve në RDGJ dhe pika kulmore e rezistencës kundër krijimit të një diktature të re.

Zonja dhe zotërinj, një gjë është e sigurt: Në rast se ushtria sovjetike në këtë ditë të 17 qershorit 1953 do të kishte qëndruar në kazerma, atëherë SED-ja nuk do të kishte arritur ta rimernte sundimin që i kishte dhënë Moska dhe përmbysja e RDGJ-së do të ishte arritur në atë kohë – dhe jo pas 36 vitesh – në vitin 1989 – dhe me shumë viktima. Sipas vlerësimeve të ndryshme demonstrata e hidhur e vitit 1953 u mori jetën rreth 50 deri 125 personave, mbi

njëmijë u plagosën, një pjesë e të cilëve pësuan plagosje të rënda, dhjetë deri pesëmbëdhjetë mijë kryengritës u arrestuan dhe morën dënime të gjata me burgim, disa madje u ekzekutuan në bazë të ligjit të luftës. Shumë prej personave të dënuar për politikë qëndruan në burg deri në fillim të viteve shtatëdhjetë.

Shtypja e kryengritjes së datës 17 qershor 1953 e traumatizoi rëndë dhe për një periudhë afatgjatë popullsinë e RDGJ-së. Për ata qytetare dhe qytetarë, të cilët në vitin 1953 dolën në barrikada apo përjetuan si spektatorë përtej rrethimit shtypjen brutale të protestës, leksioni tronditës për jetën e tyre në vazhdim ishte, se diktatura komuniste nuk ishte në gjendje që ta kundërshtonte me forcat e veta fuqinë e Bashkimit Sovjetik. Edhe ata që shpresonin për një ndërhyrje të Republikës Federale Gjermane apo të fuqive perëndimore, u zhgënjyen.

Ishte vërtet dekurajuese. Kur në periudhën në vijim u bë e qartë, se RDGJ-ja synonte të mbetej e pozicionuar në sistemin e pushtetit sovjetik dhe pjesa më e madhe e njerëzve i humbën shpresat e tyre për bashkim të fuqive të dikurshme në çështjen gjermane, për shumë persona arratisja në Gjermaninë Perëndimore demokratike shihej si mundësia e vetme për t'i shpëtuar një herë e mirë regjimit të SED-së.

Qindra mijëra vetë vendosën të vepronin kështu dhe e braktisën me zemër të thyer vendin e tyre të lindjes, lanë pas të afërmit, miqtë dhe pronat e tyre. Për ata, të cilët me gjithë jetën e vështirë qëndruan në vend, mënyra e zhvillimit të kryengritjes dhe dështimi i saj tragjik, ishin një paralajmërim, se të ardhmen ose duhej të silleshin me qetësi dhe të ktheheshin në jetën e tyre private, ose të synonin ndryshime politike sidomos nëpërmjet rrugës së reformave graduale.

17 qershori 1953 natyrisht që i preku shumë edhe gjermano-perëndimorët, të cilët ndoqën ngjarjet e përgjakshme në Lindje të vendit dhe e kishin të pamundur që të vepronin. Por jo vetëm shtresat e gjera të popullsisë, por edhe qeveria dhe partitë ishin thellësisht të tronditura dhe të lënduara. Nën peshën e përshtypjeve të ngjarjeve në RDGJ, qeveria federale gjermane në Bon vendosi pothuajse dy javë më vonë, që datën 17 qershor ta shpallë “ditën e bashkimit gjerman”. Në këtë mënyrë dita e kryengritjes në RDGJ u shpall festë kombëtare në Republikën Federale të Gjermanisë.



Pamje nga Muri i Berlinit në rrugën Bernauer Strasse

© Land Berlin/Thie



Pamje nga qendra përkujtimore për Murin e Berlinit në rrugën Bernauer Strasse

© Berlin Partner/FTB-Werbefotografie

Kryengritja popullore e datës 17 qershor 1953 shënoi një cezurë edhe për klikën drejtuese të SED-së. Erdhi momenti që Partia shtetërore e tronditur në themelet e saj ta kuptonte, se ajo ishte duke vepruar *kundër* popullit dhe se në zgjedhje demokratike ajo nuk do të gjente mbështetjen e tij. Për drejtuesit e partisë trauma e kryengritjes popullore do të vazhdonte deri në rënien e shtetit në vitin 1989. Kudo dhe në mënyrë të përsëritur regjimi dyshonte, se mund të vinte një “ditë e re X”, siç e konsideronte në fjalorin e tij sunduesi i SED-së. Madje edhe në gushtin e viti 1989, tre muaj përpara rrëzimit të murit, Ministri për Sigurinë e Shtetit, tashmë në moshë të thyer, Erich Mielke, pyeti gjatë një bisede pune me kolonelët dhe gjeneralët e tij: “A është e vërtetë, që nesër do të jetë data 17 qershor”. Pra, në një farë mënyrë, ai dukej se kishte një farë të drejte.

Drejtuesit e lartë të SED-së nuk nxorën asnjë lloj mësimi nga ngjarjet e 17 qershorit 1953. Trysnia politike mbi njerëzit vazhdoi pa ndërprerje, ristrukturimi socialist i ekonomisë dhe i shoqërisë vazhdoi pa ndalim dhe me pasoja dramatike: Në periudhën kohore midis qershorit 1953 deri në gusht 1961 numri i emigrantëve u rrit në mbi dy milionë, mes tyre para së gjithash të rinj të arsimuar mirë dhe intelektualë. Po realizohej një i ashtuquajtur “votim me këmbë” dhe numri i të larguarve po rritej në mënyrë të pandërprerë. RDGJ-ja ndodhej në buzë të greminës.

Të gjithë e dinë se si reagoi klika drejtuese e SED-së. Zhvillimet çuan në *traumën e dytë të madhe* për njerëzit në RDGJ: ndërtimin e Murit të Berlinit. Më 13 gusht 1961 partia duke përdorur gurë dhe tela me gjemba deklaroi përfundimisht falimentimin e saj politik dhe në këtë mënyrë i dha sistemit të saj edhe pothuajse 30 vjet mëshire.

Më kujtohet ende me saktësi, se si e kam përjetuar personalisht ditën e ndërtimit të murit. Bashkë me grupin e të rinjve të komunës isha për pushime në kështjellën Mansfeld, një kamp pushimi i kishës protestante në landin e sotëm Sachsen-Anhalt. Herët në mëngjes në dëgjuam në radio, se kufiri midis Berlinit Lindor dhe atij Perëndimor ishte mbyllur. Në një grup djemsh 17- dhe 18-vjeçarë u mblodhëm tek dhoma e larjes dhe këndonim me hare: “Berlini u mbyll, Berlini u mbyll!” Në këtë moment ne nuk e kishim kuptuar aspak, se ç’gjë e tmerrshme kishte ndodhur. Por kjo u kuptua shpejt.

Njëmbëdhjetë ditë pas izolimit, humbi jetën në breshërinë e plumbave të ruajtësve të kufirit personi i parë që tentoi të kalonte murin. Ky ishte momenti kur të gjithë e kuptuan qartë, se

natën e 13 gushtit 1961 më shumë se 17 milionë gjermanë që jetonin pas murit ishin shndërruar në robër të diktaturës komuniste. Pothuajse të gjitha lidhjet u prenë, me mijëra familje u ndanë me dhunë, ndër to edhe familja ime.

Ndarja e gjermanëve ishte derdhur në beton. Deri në vitin 1989, rreth 1000 vetë e paguan me jetën e tyre tentativën për ta kaluar këtë kështjellë çnjerëzore. Dhjetëra mijëra mbetën invalidë nga plumbat apo u arrestuan dhe vuajtën për vite të tëra në burgje.

Pas shtypjes së përgjakshme të kryengritjes popullore tetë vite më pas mbërriti edhe trauma e dytë e vështirë, të cilët duhet ta vuanim sidomos në gjermano-lindorët. Nëse në vitin 1953 ne mësuam, se dalja hapur kundër sunduesit totalitar është e pashpresë, tashmë neve na u hoq edhe mundësia e fundit drejt lirisë, pra për t'iu shmangur diktaturës duke u arratisur. Tashmë nuk kishte më asnjë rrugëdalje. Ishim plotësisht të pambrojtur përpara regjimit.

E detyruar nga nevoja pjesa më e madhe u përshtat gjatë viteve me sistemin totalitar, në mënyrë që të bënte të paktën një jetë në dukje normale. Në publik thuheshin ato gjëra që donte partia dhe, sa herë ishte e mundur, njerëzit mbylleshin në privatësinë e tyre dhe në cepat e fshehtë të shoqërisë, mbase për të gjetur atje fatin e tyre. Por mbetej edhe një rrugëdalje e fundit, edhe pse e pakëndshme: *emigrimi i përnatshëm shpirtëror*, që qysh prej fillimit të viteve 60-të erdhi duke u rritur. E kam fjalën për kalimin e kufirit brenda Gjermanisë nëpërmjet *televizionit perëndimor*, i cili për periudhën pas ndërtimit të murit u shndërrua në pjesë përbërëse të ofertës informative të gjermano-lindorëve dhe ishte kundërpeshë ndaj propagandës së mediave shtetërore. Kundërshtimi dhe shqetësimi fillestar i SED-së ndaj antenave që nënshtetasit e saj i kishin drejtuar nga Perëndimi, u shndërrua shpejt në një luftë kundër mullinjve të erës. Rreth 85 % e të gjithë qytetarëve të RDGJ-së, përjashto vetëm banorët në ishullin Rügen dhe ata të së ashtuquajturës “Lugina e të Paditurve” përreth Dresdenit, ku ishte e pamundur të kapje valët e programeve të Perëndimit, mund t'i ndiqnin programet e Republikës Federale Gjermane pothuajse çdo mbrëmje në dhomën e ndenjes. Ata shikonin se si jetonin gjermano-perëndimorët dhe se çfarë standardi jetese kishin arritur në krahasim me ata – natyrisht sipas mënyrës që i nxirrte në pah televizioni. Në këtë mënyrë për vite me radhë tek shumë prej tyre u kristalizua imazhi i “Perëndimit të artë”. Pas ribashkimit në vitin 1990 kjo solli me vete detyrimisht pritshmëri që shpreheshin në pyetje të tilla si: Pse duhet të jetojnë më keq gjermanët në Magdeburg apo Lajpcig, sesa gjermanët në Këln apo Mynih? Natyrisht që njerëzit në Lindje donin të jetonin sa më shpejt të qe e mundur po aq

mirë sa ata në Perëndim. Kush mund t'ua merrte për keq këtë? Pasojë ishte nga njëra anë shprehja e një farë zhgënjimi, kur këto pritshmëri fillimisht dështuan në realitet, dhe nga ana tjetër reagimi i irrituar i gjermano-perëndimorëve ndaj padurimit të gjermano-lindorëve. Fillimisht, siç e dimë kjo krijoi probleme të mëdha në afrimin e gjermanëve pas vitit 1990.

Kur në vjeshtën e vitit 1989 në rrugët e RDGJ-së dolën me qindra mijëra vetë për të kërkuar liri dhe demokraci, kur lëvizja opozitare e RDGJ-së u bashkua me personat që donin të largoheshin nga vendi dhe sistemi i rrënuar i diktaturës së SED-së ishte në shkatërrim e sipër, mediat perëndimore shërbyen përsëri si ura informuese. Rëndësia e të tyre nuk mund të shprehet me fjalë.

Por brenda vendit kishte edhe forca, të cilat e mbështesnin lëvizjen opozitare. Kisha protestante në RDGJ u ofroi në vitet 80-të grupimeve të ndryshme një hapësirë, që nuk gjendej në vend tjetër, hapësirë në të cilën testohej “marshi i duhur”. Në shumë bashkësi kishtare apo në ndërtesat e tyre u krijuan grupe pune për paqe dhe ekologji si edhe më vonë grupe, të cilat u angazhuan për të drejtat e njeriut dhe demokracinë në shoqërinë e tyre – me fjalë të tjera: opozita kundër diktaturës së SED-së. Njerëzit, të cilët angazhoheshin fuqimisht këtu për qëllimet e tyre, mbanin mbi supë një rrezik të madh personal; shpesh atyre u kanosej rreziku nga radhët e pushteti dhe nga organet e sigurimit. Për ta bërë më të kuptueshëm motivimin e këtyre grave dhe burrave, të cilët për veten e tyre thoshin: “*Unë do të guxoj! Të bëhet ç'të bëhet!*”, unë dua të citoj këtu të madhin Vaclaw Havel:

Shpresë
nuk është bindja,
se diçka do të përfundojë mirë,
por siguria,
se diçka ka kuptim,
pavarësisht, se si do të përfundojë.

Por para së gjithash një meritë kryesore në kryengritjen në RDGJ kanë padyshim kishat dhe kjo pikë është shumë e rëndësishme për mua: gjatë meditimeve për paqe dhe gjatë demonstratave përkujtimore njerëzit u ushqyen aq shumë me paqen nëpërmjet shprehjes “Jo dhunës!”, sa që në fakt kjo mundësoi edhe një “*revolucion paqësor*”. Diktatura e SED-së duhej rrëzuar pa gjakderdhje – ne gjermanët nuk gjejmë fjalë sot për ta shprehur këtë fat të pabesueshëm!

Me qindra mijëra vetë dolën në vjeshtën e vitit 1989 nëpër rrugët e Lajpcigut, Berlinit, Dresdenin dhe në shumë vende të tjera dhe pa marrë parasysh rrezikun personal që i kërcënonte, kërkuan liri dhe një bashkim të shpejtë të Gjermanive. Tek shumë të moshuar tmerri i datës 17 qershor 1953 vazhdonte të ishte prezent, ndërsa të rinjve ai u ishte transmetuar “me qumështin e nënës”. Edhe shtypja e përgjakshme e protestave studentore në Pekin në qershor 1989 ngjalli ndjenja negative. Dhe *megjithatë* njerëzit dolën nëpër rrugë, dhe numri i tyre sa vinte e shtoej. Këtë herë kërkesat e paraqitura nga popullsia e RDGJ-së për demokraci, liri dhe bashkimin e Gjermanisë u kurorëzuan me sukses.

Traumat e 17 qershorit 1953 dhe 13 gushtit 1961, të cilat i mbartte brenda vetes qoftë me vetëdije apo pa vetëdije secili prej demonstruesve në rrugë, u tejkaluan me thirrjet “Ne jemi populli!”. Guximi dhe vendosmëria e njerëzve solli më në fund çlirimin me forcat e veta, në revolucionin e parë dhe të suksesshëm në tokën Gjermane ndër vite.

Pika emocionale kulmore e këtij revolucioni paqësor, të cilin e kanë të gjallë para syve ende shumë njerëz në mbarë botën, është sigurisht data 9 nëntor 1989, dita e rrëzimit të murit.

Në këtë mënyrë 9 nëntori 1989 është shndërruar në një ditë të vërtetë hareje për ne gjermanët. Kjo datë na kujton njëkohësisht çdo vit edhe kapitullin e errët dhe të palavdishëm të historisë sonë, të cilin ne nuk mund ta lëmë mënjane dhe as nuk duam ta lëmë mënjane.

Sepse për të kuptuar vlerën e vërtetë të lirisë dhe të demokracisë, të cilën ne sot e shohim si diçka plotësisht të vetëkuptueshme, është e nevojshme, që të mos harrojmë, se çfarë do të thotë të jetosh në një diktaturë.

Sepse guximi qytetar, i cili para 20 viteve i nxori njerëzit e RDGJ-së në rrugë për të flakur diktaturën komuniste nëpërmjet një revolucioni paqësor, është shpirti i qytetarisë, për të cilin ne kemi nevojë në shoqërinë tonë të sotme. Sepse demokracia, liria dhe respektimi i të drejtave të njeriut nuk janë të vetëkuptueshme, por janë arritur me luftë të ashpër dhe kanë nevojë për mbrojtje të vazhdueshme. Këtë nuk duhet ta harrojmë kurrë!

Dhe ai që e di, se si jetohej pa liri në diktaturë – 28 vjet të murosur në Gjermaninë Lindore – ai është në gjendje ta kuptojë sot vlerën e lirisë. Për këtë liri të vyer në demokraci, të cilën në ditët e sotme ne e konsiderojmë si të vetëkuptueshme, duhet të kujdesemi dhe ta ruajmë dhe

po të jetë e nevojshme edhe ta mbrojmë. Liria dhe demokracia nuk janë të vetëkuptueshme, por janë arritur me luftë të ashpër dhe duhet të rifitohen prej nesh vazhdimisht. Këtë nuk duhet ta harrojmë kurrë!

Muri i Berlinit dhe kufiri ndërgjerman – instrumente të sigurimit të sundimit të Partisë së Bashkuar Socialiste të Gjermanisë (SED)

Dr. Ulrich Mählert

Hyrje

Referati im i kushtohet regjimit, të cilin e kishte ngritur diktatura e SED-së në kufirin me Gjermaninë Perndimore dhe rreth Berlinit Perndimor. Ky regjim kufiri bëri të mundur që nga viti 1961 deri në vitin 1989 asnjë person të mos largohej dot nga Republika Demokratike Gjermane (RDGj) kundër vullnetit të pushtetit partiak dhe shtetëror, pa vënë në rrezik jetën dhe lirinë e tij. Në referatin tim, do të trajtoj fillimisht, zhvillimin e këtij regjimi kufitar. Në pjesën e dytë do të ndalem për të shpjeguar më nga afër urdhërin për të qëlluar me armë dhe viktimat e regjimit të kufirit. Kurse në pjesën e tretë të referatit tim dua të argumentoj, se pse unë jam i mendimit se regjimi i kufirit i SED-së ishte instrumenti më famëkeq me të cilin SED përpiqej të ruante sundimin e saj në RDGj.

Historia dhe zhvillimi i regjimit të kufirit të Partisë së Bashkuar Socialiste të Gjermanisë (SED)

13 gushti 1961 ka hyrë në librat e historisë si dita e ndërtimit të Murit të Berlinit. Në fakt, fillimisht ishin vetëm disa barriera me tela me gjëmba, të cilat u vendosën në kufirin që ndante dy pjesët e qytetit. Vetëm më 15 gusht filloi puna e ndërtimit nën një kontroll ushtarak, ku rrjetat e telit u zëvendësuan hap pas hapi me një mur të ngritur me elementë betoni dhe blloqe tullash. Dalëngadalë „Muri i Berlinit“ mori formë. Por duhet të kalonin edhe shumë vite deri sa Muri arriti shkallën e zgjerimit të viteve 1980-të, pamja e të cilit na ka mbetur në mëndje deri sot.

Ajo çka ndodhi në Berlin 16 vjet pas përfundimit të Luftës II Botërore kishte nisur të ravijëzohej qysh në verën e vitit 1952, ideja për të ngritur një mur 1.378 km të gjatë brënda kufirit ndërgjerman. 7 vjet pas përfundimit të Luftës II Botërore dhe tre vjet pas krijimit të dy shteteve gjermane nga Deti Baltik deri në kufi me Çekosllavakinë u shtri një gardh me tela me



Fillimi i ndërtimit të Murit të Berlinit



Kullë vrojtimi në kufi

gjëmbe. Paralelisht më të, duke filluar nga viti 1954, në anën e kufirit të Gjermanisë Lindore, u spastrua popullsia përgjatë një zone të ndaluar prej 5 km, në të cilën lejoheshin të lëviznin vetëm banorët e zonës. Kur një banor i kësaj zone donte të ftonte dikë për vizitë, ai fillimisht duhet të merrte një leje kalimi për kushërinjtë apo miqtë. Por edhe kjo nuk mjaftonte: Qysh në vitin 1952 disa banorë të zonës së ndaluar që konsideroheshin si “jo të besuar”, u dërguan nën kërcënimin e dhunës për të jetuar në pjesë të tjera të vendit. Deklarimi i masave të detyrimit ishte shprehje e pastër e mosrespektimit të të drejtave të njeriut. Kjo masë u pagëzua me emrin „Aksioni parazitët”.

Në vitin 1961, kur regjimi i SED-së e kishte murëzuar plotësisht RDGj-në, nisi edhe përforcimi i kufirit ndërgjerman. Madje gjatë vitit të ndërtimit të Murit, në kuadrin e aksionit „Konsolidimi“, u kryen transferime dhe zhvendosje të tjera të detyruara të popullsisë që banonte në afërsi të zonës së kufirit – këtë herë madje me emra të koduar si „lule gruri“, „lulet“ apo „ajri i pastër“. Në dy aksionet e mëdha që pasuan në vitet 1952 dhe 1961, rreth 10 000 personave u rrëmbyen vendlindjen dhe pasurinë e tyre.

Në intervalin kohor midis 1962 dhe 1969 numri i grave dhe i burrave, të cilët pavarësisht prej vendosjes së telave me gjëmbe, minave dhe urdhërit për të qëlluar, ia kishin dalë mbanë të kapërcenin çdo vit kufirin ndërgjerman dhe të arratiseshin drejt Berlinit Perëndimor, ra nga 5.800 në rreth 1.200. Por për pushtetin partiak dhe shtetëror çdo njëri nga ata që „kapërcente pengesat“ ishte shumë. Kriminalizimi i tyre pasqyrohet edhe në shprehjen „thyerësit e regjimit të pengesave dhe shkelësit e kufirit“. Duke i quajtur me një shprehje të tillë, ata ishin më lehtë t’i vije në shënjestër për t’i vrarë se sa „të arratisurit“. Në vitin 1968 hyri në fuqi një kod i ri penal në RDGj, i cili e cilësonte “kalimin ilegal të kufirit” si krim, për të cilin mund të dënoheshe me deri në 8 vjet heqje lirie.

Njëkohësisht me sanksionimet juridike vazhdoi edhe zgjerimi i elementeve mbrojtës të kufirit. Në fillim të viteve 1970-të u ngritën 600 kulla vrojtimi, rreth 1000 bunkerë dhe qendra nëntokësore në qytetet pranë kufirit ndërgjerman. Xhenerët kishin planifikuar me kohë 900 kilometër klon të veshur me tela me gjëmbe, kështu që rojet e kufirit mund të zinin pozicione shumë shpejt për të sulmuar, madje edhe për t’i qëlluar ata që arratiseshin, kur këta të fundit shkaktonin ndonjë sinjal nëpër paisjet e vendosura në kufi. Dhe në fund vinin 1,3 milionë mina tokësore, të cilat duke filluar nga viti 1961, u vendosën në një gjatësi prej 1.100 km

përgjatë murit të përforcuar dyfish me tel dhe tel me gjëmba. Por përgjegjësit vazhdimisht ishin të pakënaqur me minat. Nuk mjaftonte që shumë prej tyre shpërthenin nga ndikimi i agentëve atmosferikë, ose nga që kishin dalë jashtë përdorimit apo nga kontakti me kafshët e egra; një pjesë jo e vogël e tyre rezultoi se nuk funksiononte. Prandaj dhe diktatura e SED-së duke filluar nga vera e vitit 1972 demonstroi forcën e saj novatore, duke ngritur një gardh me pllaka metalike që ishte i vështirë të kapërcehej, i cili krijoi kështu edhe vijën e fundit penguese drejt perëndimit. Në këtë pengesë regjimi instaloi edhe një shpikje të tijën, “një minë thërmuese, e cila kishte një drejtim të përcaktuar shpërndarjeje të ciflave”; ajo u quajt SM-70. Secili nga këta automatë vdekjeprurës që u vendosën në “murin mbrojtës antifashist” përmbante 110 gram ngarkesë TNT, e cila pas shpërthimit shpërndante 80 cifla çeliku – sigurisht llogaritja ishte bërë e tillë, që ato të drejtoheshin nga lindja, pra ishte e qartë, ndaj atyre që donin të largoheshin nga RDGj-ja.

Personat që përpiqeshin të arratiseshin duke kaluar kufirin ndërgjerman në vitet e fundit të regjimit të SED, fillimisht, duhet të kalonin pa u vënë re zonën e ndaluar pranë kufirit, zonë kjo që mund të kalohej vetëm me autorizim. Kjo zonë, ku jetonin rreth 200. 000 vetë në mbi 300 fshatra e lokalitete, ishte fillimisht 5 km e gjërë, ndërsa në vitet e mëvonshme u kufizua pjesërisht në 3 km. Këtu nuk bënin roje vetëm ushtarët e kufirit, policia popullore dhe bashkëpunëtorët e sigurimit të shtetit, STASI, duke i bërë sytë katër. Shteti partiak kishte rekrutuar në radhët e popullsisë vendase të këtyre zonave të ashtuquajturit ndihmës vullnetarë të trupave të kufirit. Mbi 7000 prej tyre, kryenin në vitin 1988 në uniformë, edhe pse të pa armatosur, një shërbim ndihmës, duke punuar me kohë të pjesëshme, në orët e mbrëmjes jashtë orarit të punës. E kush do të mundte t’i kalonte të gjitha këto prita, me apo pa uniformë, kur 300 deri 1000 m para vijës së vërtetë të kufirit kishte patrulla kontrolli para brezit të butë 2 m të gjërë, ku toka ishte punuar e shkrifët. Kjo shërbente për të gjetur gjurmët që linin ata që orvateshin të kalonin këtë brez kloni për t’iu afruar pastaj murit 2,40 m të lartë me sinjale kufitare dhe gardhin barrikadues. Pllakat e betonit që ishin futur thellë në tokë pengonin hapjen e ndonje trasheje nën mur. Në lartësinë 2 m ishte vendosur një pengesë tjetër, 40 cm e lartë, në formë y-je me konstruksion me tela me gjëmba, e cila e vështirësonte kapërcimin e këtij muri. Por sfidën më të madhe e përbënin ato distanca të shkurtëra deri te konstruksioni në formë y-je ku ishin shtrirë telat që perceptonin çdo sinjal. 24 prej tyre ishin të ngarkuara me rrymë elektrike të dobët. Në qoftë se personi që po arratisesh prekte dy nga këta tela, atëherë mbyllej një qark i shkurtër, i cili përcillte në kullat e vrojtimit një alarm pa zhurmë. Menjëherë pas këtij alarmi, një grup i armatosur, i quajtur grupi i alarmit, merrte rrugën dhe

shkonte deri te kloni për të kapur personin që donte të arratisesh. Kush kishte mundur që të kalonte deri këtu pa u vënë re, mund të ndeshesh me pengesa të tjera. Në pjesën perëndimore të kësaj barriere të parë ishte një zonë që ruhej me qen kufiri, ku qenë të egërsuar kërcënonin t'i sulmonin personat që donin të arratiseshin, sapo këta të fundit të kishin kaluar gardhin. Por le të marrim rastin, sikur personi që po arratisesh kishte arritur ta kapërcente edhe gardhin sinjalizues. Edhe në këtë rast ai përsëri duhej të kalonte edhe zonën e minuar me mina shpërthyesë në drejtim të lindjes, një zonë kjo 6 m e gjerë; këtu duhet të kalonte me kujdes pa shkaktuar asnjë alarm në brezin e kontrollit dhe të hidhej përtej rrugës së klonit, pa e ditur nëse kishte shkaktuar apo jo ndonjë alarm dhe nëse gjurmuesit po e ndiqnin nga pas. Tani duhej kaluar edhe barriera e fundit: muri 3 m i lartë me rrjetë metalike, pra muri i kufirit. Këtu ishin instaluar pllaka metalike të parafabrikuara, të fiksuara në shtylla betoni, ku nuk mund të mbaheshe dot me dorë, pasi buzët e sipërme ishin aq të mprehta, sa nuk mund të kapeshin me dorë. Kjo ishte një garë me kohën, të cilën vetëm pak veta e fitonin.

Si kufiri ndërgjerman në tri dekada të ekzistencës së tij u transformua edhe Muri i Berlinit, rreth 160 km i gjatë Kush i afrohej kufirit, duke ardhur nga Berlini Lindor apo nga zona të tjera në brendësi të vendit, ndeshesh në brendësi të qytetit me të ashtuquajturat mure të prapavijës ose jashtë tyre, në zona me ndërtime të dëndura, me gardhe sinjalizuese, të cilët kur i prekje jepnin sinjal se dikush po tentonte të arratisesh. Sinjalizues të tjerë si këta I prisnin të arratisurit, edhe kur këta të fundit i kishin kapërcyer muret e prapavijës. Pothuajse kudo para murit të prapavijës dhe gardhit sinjalizues kishte një zonë barriere, e cila lejohej të kalohej vetëm me një autorizim të shkruar qartë. Mbi 11.000 ushtarë dhe oficerë ishin në fillim të vitit 1989 nën urdhërat e komandës kufitare „Mitte“, e cila kishte detyrë të mbronte Murin e Berlinit nga popullsia e vetë. Ata bënë shërbim në 186 kulla vrojtimi si dhe në 31 kulla speciale ku ishin vendosur forcat drejtuese. Kush arrinte të kalonte vijën e parë të përforcuar – i zbuluar apo jo – atij i duhej të kapërcente edhe një rrip kufitar toke nga 30 deri 500 m të gjerë, i cili në disa vende ishte përforcuar me pengesa të minuara. Në këtë brez kufiri kalonte edhe kloni, një trase, ku sot lëvizin njerëzit me biçikleta, të cilët ndjekin rrugën ku dikur ishte ngritur e kalonte muri. Deri në momentin e rrëzimit të Murit në këtë rrugë kloni lëviznin ushtarët e kufirit, kur jepej sinjali se aty po kalonte ndonjë i arratisur. Ndryshe nga kufiri ndërgjerman brezi kufitar me Berlinin Perëndimor nuk u minua kurrë. Në vend të tyre kishte një trase drite 161 km të gjatë, e cila ndriçohej çdo natë, në mënyrë që asnjë person që mendohej të arratisesh të mos gjente asnjë segment të errët për të kaluar barrierën e fundit para se të dilte në liri. Muri i prapavijës në brendësi, kishte deri në fund të diktaturës tri segmente:

42 km ishin një lloj barrikade krijuar me elementë betoni të tipit „muri kufitar 75“, çka sot krijon edhe përfytyrimin tonë për Murin e Berlinit. Ky përbëhej nga segmente beton armeje 3,60 m të lartë dhe 1,20 m të gjërë, mbi 2,7 ton të rëndë, ku në pjesën e sipërme ishte instaluar një tub betoni, i cili e vështirësonte më tej mundësinë për t'u kacavjerrë mbi të. Në anën lindore, i lyer me të bardhë, ndërsa në anën perndimore këto blloqe të murit ishin shndërruar në sipërfaqe projeksioni për artikulime artistike apo politike. Më tej kishte segmente më të mëdha, ku muri ishte siguruar me pllaka betoni (58 km) ose me gardh me pllaka dhe rrjeta metalike (48 km). Personat që tentonin të arratiseshin dhe arrinin që me gjithë këto masa penguese dhe urdhërit për të qëlluar ndaj tyre, ta kapërcenin këtë barrierë të fundit, u duhej të bënin shumë kujdes që të kalonin edhe këtë mur të fundit, sepse edhe pas kalimit të tij nuk dilnin menjëherë në tokën e lirë. Kjo sepse është fakt, që muri nuk shkonte direkt e në vijën kufitare drejt Berlinit Perndimor, por ai kthehej përsëri drejt lindjes. Në distanca jo të rregullta ishin montuar dyer çeliku. Këto u mundësonin trupave të kufirit jo vetëm të hynin për të kryer riparime dhe rregullime në anën perndimore të murit. Në këtë rrugë mund të kapeshin edhe demonstruesit apo artistët që pikturonin murin dhe që guxonin t'i afroreshin atij në zonën e Berlinit Lindor.

Në propagandën e partisë komuniste të Gjermanisë Lindore, SED, muri dhe kufiri quheshin „muri mbrojtës antifashist“, me të cilin shteti i punëtorëve dhe i fshatarëve mbrohej nga përpjekjet për ta dobësuar dhe rrëzuar. Në këtë propagandë Republika Federale Gjermane akuzohej si fashiste. Deri në vitin e rrëzimit të Murit kjo gënjeshtër propagandistike nuk mund të vihej në pikëpyetje publikisht. Për njerëzit në RDGj ishte e qartë që në fillim se regjimi i kufirit nuk ishte ngritur për ta mbrojtur atë nga jashtë, por nga brënda. Pa Murin e Berlinit dhe kufirin ndërgjerman SED nuk mund ta mbronte sundimin e saj. Këtë mendim kishte edhe udhëheqja e partisë dhe e shtetit, e cila mendonte vazhdimisht për ta perfeksionuar këtë regjim kufiri.

Urdhëri për të qëlluar dhe viktimat e regjimit të kufirit të SED

„Shkelësit e kufirit duhen arrestuar ose asgjësuar“ - me këtë urdhër niseshin ruajtësit e kufirit të RDGj çdo ditë në postin e tyre të shërbimit menjëherë pas ndërtimit të murit në vitin 1961: Ata bënin patrullimin e vdekjes përgjatë kufirit ndërgjerman si dhe rreth Berlinit Perëndimor. „Gjatë përpjekjeve për të kaluar kufirin duhet të përdoren armët e zjarrit pa hezitim“, kështu deklaronte Erih Honeker në vitin 1974 para Këshillit Kombëtar të Mbrojtjes të RDGj-së.

Njëkohësisht ai kërkonte „të lavdërohen shokët që kanë përdorur me sukses armët e zjarrit“. Për regjimin e SED-së gratë dhe burrat që përpiqeshin të largoheshin nga RDGj me çdo çmim, ishin „shkelës të kufirit“, „provokatorë“ dhe „kriminelë“. Dhe këta e nuk kishin të drejtë të jetonin, në rast se kishin arritur të kalonin paisjet penguese tepër të sofistikuara dhe atëhere kur nuk ishte më e mundur t'i arrestoje.

Qysh nga viti 1990 ish-përgjegjësit e SED-së dhe të aparatit ushtarak të RDGj e mohojnë se kishte pasur një urdhër të tillë. Me gjetje mëndjempërhta ata justifikohen se bazat ligjore që kanë qënë në fuqi në kohë të ndryshme për përdorimin e armëve të zjarrit në RDGj paskan qënë vetëm një udhëzim, kurrësesi një detyrim për të qëlluar me armë dhe për të vrarë. Por realiteti i regjimit të kufirit të SED dokumenton qartë se si ligji i shkruar në RDGj u nënshtrorëj qëllimeve të diktaturës dhe padrejtësia ishte kthyer në sistem. Të gjitha udhëzimet për përdorimin e armëve të zjarrit në RDGj janë mbajtur në sekret të plotë. Ushtarëve që dërgoheshin për të shërbyer në kufi, e madje edhe oficerëve të thjeshtë këto urdhëra u përcillleshin vetëm gojarisht gjatë takimit ditor para marrjes së shërbimit të patrullës. Oficerët madhorë nuk kishin asnjë dyshim se arma e zjarrit duhej të përdorej rigorozisht. Në fund të fundit ishin pikërisht ata vetë që u duhej të justifikoheshin para eprorëve të tyre për çdo arratisje që kishte sukses. Natyrisht pas 1990 janë të njohur vetëm pak raste kur kufitarët janë dënuar, sepse ata në raste serioze nuk kanë zbatuar udhëzimet dhe nuk i kanë qëlluar pas shpine personat që tentonin të arratiseshin. Por stërvitja e vazhdueshme ushtarake dhe përzierja e kodit penal me shpërblimin, bënë që zakonisht të funksiononte vaj edhe ingranazhi më i fundit i makinerisë së vrasjes, pra edhe ushtarët e kufirit.

Në vitet 1970-të dhe veçanrisht në vitet 80-të udhëheqja e SED-së e kufizoi për një kohë të shkurtër përdorimin e armëve të zjarrit. Kur vinin mysafirë të lartë shtetërorë, ose kur kishte bisedime të rëndësishme ndërkombëtare, lajmet mbi persona të vrarë gjatë përpjekjes për arratisje shiheshin si prishje të atmosferës. Kështu që historia e RDGj-së dënon ato gënjeshtër, të cilat e mohojnë një praktikë, të cilës i dha fund ministri i Mbrojtjes i RDGj-së vetëm në fillim të prillit 1989, përsëri në formën e urdhërave të trasmetuar gojarisht. Vetëm pas kësaj përdorimi i armëve të zjarrit lejohej vetëm në rastet kur kërcënohej jeta e një ushtari të kufirit, por jo për të penguar arratisjen e dikujt.

Deri tani nuk është i njohur numri i grave, i burrave dhe i fëmijëve që kanë humbur jetën gjatë periudhës nga viti 1952 deri 1989 në përpjekje për të kapërcyer kufirin ndërgjerman, apo duke

filluar nga viti 1961 për kapërcimin e Murit të Berlinit, për të kaluar me not Detin Baltik apo për të gjetur një vrimë në perden e hekurt për t'u larguar nga vendlindja drejt Çekosllavakisë, Hungarisë ose Bullgarisë. Vetëm për viktimat e Murit të Berlinit ka nisur tani një përpjekje fillestare. Pas një pune kërkimore intensive në vitin 2009 u botua një manual biografik, i cili përshkruan jetën e 136 personave që kanë rënë viktimë e Murit të Berlinit. Botuesit e këtij vëllimi, Hans-Hermann Hertle dhe Maria Nooke janë të ndërgjegjshëm se këtu flitet për një numër minimal viktimash. Sipas tyre ka 98 persona që janë vrarë gjatë përpjekjes për të kaluar kufirin, kanë vdekur ose kanë vrarë veten nga dëshpërimi. 30 veta nga lindja dhe perëndimi kanë humbur jetën pa pasur aspak ndonjë qëllim për të kapërcyer murin. Disa herë ata kanë qënë viktimat të ndonjë plumbi qorr apo të shkrepjeve të gabuara vdekjeprurëse të ndonjë kufitari të RDGj-së. Ato ishin – sikurse thuhet sot rëndom – dëme kolaterale të një regjimi kufitar çnjerëzor. Ashtu si edhe në rastin e një djali 8-vjeçar turk, i cili në vitin 1972 ra në Kreuzberg në lumin Spree. Ky ishte qytetar i Berlinit Perëndimor, por meqë lumi që zonë kufitare nuk lejohej që t'i jepej asnjë ndihmë nga bregu perëndimor. Kur arriti në vendin e ngjarjes varka e kufirit e RDGj-së, Cengaver Katranci kishte humbur jetën. Së fundmi historianët numërojnë edhe 8 ushtarë kufitarë të RDGj-së, që janë vrarë në shërbim nga kolegët dezertorë, nga persona që tentonin të arratiseshin, nga ndihmësit e tyre apo nga policia e Berlinit Perëndimor. Në këtë bilanc të tmerrshëm kemi edhe më tepër se 250 të moshuar, të cilët kanë vdekur nga pasojat e infarktut të zemrës gjatë ose direkt pas kontrollit në qendrat e kalimit të kufirit në Berlin dhe rreth tij. Dyshoj se numri i viktimave të Murit të Berlinit nuk do të mund të jepet kurrë me saktësi. Megjithë kërkimet intensive dy historianët kanë arritur të sqarojnë pa kurrëfarë dyshimi 24 raste, që u janë bërë të njohura nga burime të ndryshme.

Deri sot nuk është ndërmarrë ndonjë investigim i hollësishëm krahasues për viktimat e kufirit ndërgjerman rreth 1.400 km të gjatë. Prandaj dhe nuk duhet të habitemi që numri i atyre që kanë humbur jetën këtu nga viti 1952 deri në vitin 1989 është deri sot i diskutueshëm. Ai lëviz nga një numër minimal prej 161 të vdekurish, që u referohet hetimeve të prokurorisë së Berlinit dhe që pa dyshim u referohet akteve të dhunës së forcave të sigurimit të kufirit të RDGj-së, deri në 256 të vdekur në kufi, që ka numëruar zyra qendrore e hetimit për krimet e qeverisë. Madje ka shifra që flasim për deri në 372 viktimat, në rast se u referohemi të dhënave të shoqatës „13 gushti“. Akoma më drastike janë devijimet kur pyesim për numrin e personave që kanë vdekur gjatë përpjekjes për të dalë në liri nëpërmjet Detit Baltik. Një grup qendror hetimor i ngritur në vitet 1990 ka nxjerrë në dritë këtu 8 raste, ndërsa shoqata „13 gushti“ numëron deri 189 persona. Tërësisht i panjohur mbetet numri i gjermanolindorëve që

në përpjekjet e tyre për ta kapërcyer perden e hekurt në vende të tjera të bllokut lindor, përfunduan në vdekje. Kjo kërkon një investigim të hollësishëm e të mëtejshëm, dhe jo vetëm për të përcaktuar me saktësi numrin e viktimave të kufirit. Shumë më e rëndësishme është që të mos bien në harresë, njerëzit që e paguan me jetën e tyre dëshirën për liri.

Regjimi i kufirit – garanti i diktaturës së SED

Historia lipset të tregojë se muri dhe kufiri ndërgjerman nuk kanë qenë aspak fakte të pandryshueshme, dhe se muri, nuk do të mund qëndronte akoma edhe 50 apo 100 vjet, sikurse kishte profetizuar Erih Honekeri në fillim të vitit 1989.

Në fund të referatit tim dëshiroj të argumentoj tezen që formulova në fillim, se regjimi i kufirit ishte instrumenti më famëkeq ndër instrumentet e shumtë të sundimit që kanë pasur në dispozicion diktaturat komuniste. Në këta instrumente sundimi bën pjesë edhe vetë Partia e Bashkuar Socialiste e Gjermanisë SED. Me më shumë se 2 milionë antarët e saj udhëheqja e partisë kishte depërtuar plotësisht në të gjitha fushat e jetës politike, ekonomike dhe shoqërore të RDGj-së. SED-ja kontrollonte dhe drejtonte njëkohësisht të gjithë sektorët e partive të bllokut dhe organizatat e masave, me anën e të cilave popullsia ishte lidhur në sistem. Partia shtet kontrollonte mediat, manipulonte drejtësinë dhe kishte në dispozicion edhe „mburojën dhe shpatën“, sikurse quhej Ministria e gjithëpushtetëshme e Sigurimit të Shtetit (Stasi), e cila me kalecët e saj kontrollonte edhe ato fusha, ku partia nuk mund të depërtonte. Për t'u përmëndur janë këtu edhe të ashtuquajturat „organe të armatosura“, policia, ushtria dhe grupet e armatosura të ndërmarrjeve, të cilat de facto i nënshtroheshin partisë SED. Dhe pastaj ishin edhe forcat e armatosura sovjetike në tokën gjermanolindore. Këto kishin shtypur kryengritjen popullore në RDGj në qershor 1953 dhe bënë të qartë se pa pëlqimin e Moskës apo me rezistencë ndaj saj ndryshimi i sistemit nuk do të ishte i mundur.

Regjimi i kufirit që vendosi SED-ja, pra mbyllja totale e kufijve të jashtëm, ishte një premisë që tregonte se mund të përdroreshin të gjitha instrumentet e tjerë të sundimit. Zhvillimi në vitet 1950-të e kishte treguar qartë këtë. Largimi dhe arratisja e vazhdueshme e rreth 3 milionë qytetarëve të RDGj-së drejt Perëndimit e kishte çuar regjimin e SED-së në fillim të viteve 1960-të në buzë të greminës. SED-së i duhej ta muroste popullin e saj, që të mund të ruante pretendimet për sundim. Për këtë urdhëri për të qëlluar, i cili që në fuqi për gati tri dekada, ishte guri qendror i themelit të regjimit të kufirit të SED-së. Ai nuk drejtohej vetëm kundër atyre që me guximin e dëshpërimit kishin guxuar ta sfidonin atë, edhe pse kjo ishte me rrezik për jetën e tyre. Urdhëri për të qëlluar kishte si objektiv të qartë vetë popullin. Çdo qytetar i

RDGj-së duhet ta kishte të qartë, se çdo përpjekje për t'u arratisur mund të dënohej pikë për pikë dhe pa proces gjyqësor, madje edhe me vdekje.

E parë nga teknika e sundimit, në regjimin e kufirit nuk kishte alternativë tjetër përveç se „ose kështu/ose ashtu“. Për popullsinë gjermanolindore qëndrimi në RDGj duhej të dukej pa alternativë. Vetëm kështu mund t'i detyroje qytetarët që të pajtoheshin me regjimin. Kush e dinte – si p.sh. në vitet 1950-të – se për t'iu shmangur kërkesave të tejskajshme të regjimit kishte një mundësi, largimi nga vendi, ky ishte i guximshëm dhe më pak i shtypur nga sistemi. Çdo funksionar i SED-së i jepte të drejtë vetes për aq kohë sa politika e Bonit në lidhje me Lindjen, të cilën e kishin lançuar dhe vënë në udhë Vili Brandt dhe Egon Bahr gjatë viteve 1960-të, cilësohej prej këtyre funksionarëve si “agresion i leckave prej shajaku”. Sepse politika ndërkombëtare e Detantës, procesi i KSBE-së, njohja ndërkombëtare e RDGj i maskonin përpjekjet e kamufluara që ndërmerre shteti partiak jo vetëm me Murin. Ndërsa regjimi i SED-së i mbajti në fuqi në mënyrë të besueshme kërcënimet me vdekje që ishin të lidhura me regjimin e kufirit deri në vitin 1989, koncesionet partiako-shtetërore, mosrealizimi i kërkesave të atyre që kërkonin të udhëtonin jashtë vendit, si dhe shitja e dhjetra mijëra të burgosurve në Republikën Federale të Gjermanisë duke filluar nga vitet 1980-të – të gjitha këto minonin bazën e sundimit të SED që e kishte çimentuar qysh në vitin 1961. Pasi pritja për të marrë lejen për të udhëtuar jashtë vendit - një valvulë e krijuar për shkarkimin e pakënaqësisë që ekzistonte në radhët e popullit, kishte më tepër tendencë që të mos realizohej, në vend të saj, në vitet 1980-të për herë të parë qysh nga ngritja e Murit u shfaq një mundësi reale, e kalkuluar në rrugë e sipër: pra të largohesh legalisht nga RDGj, edhe pse kjo mundësi ishte e lidhur me turpërime masive dhe me një farë pasigurie. Kush nuk qëndronte dot më në RDGj, kishte tashmë një alternativë të vërtetë midis të qëndruarit dhe përshtatjes nga njëra anë dhe arratisjes plot rreziqe që mund të përfundonte deri me vdekje, nga ana tjetër. Për disa mbetej vetëm opsioni për të bërë kërkesë për të udhëtuar jashtë shtetit, për të kërkuar një jetesë tjetër. Se çfarë rëndësie eminente, të madhe, kishte mbyllja hermetike e kufirit për SED, kjo u duk qartë vetëm në fund të verës 1989. Ishin ata që donin të udhëtonin për jashtë shtetit, të cilët e tronditën aq fortë regjimin e SED-së, sa që kjo lëvizje u kthye në një revolucion paqësor. Ishin qytetarët e Lajpcigut që dëshironin të udhëtonin jashtë vendit, ata që përcaktuan edhe fytyrën e demonstratave të së hënës. Ishin pamjet e gjermanolindorëve që pushtuan ambasadat në Pragë, Budapest dhe Varshavë, të cilët shfrytëzuan në Hungari çdo vrimë dhe të çarë të perdes së hekurt për t'u arratisur në perëndim, çka e destabilizoi në mënyrë vendimtare regjimin e SED-së. Presioni për të udhëtuar jashtë shtetit dhe boshllëqet që lanë të ikurit në RDGj si dhe memecllëku i sundimtarëve i dhanë opozitës së vogël

mundësi për të lëvizur. Kjo opozitë u rrit dhe duke filluar nga vera 1989 po kërkonte me sukses ndryshimet. Për revolucionin paqësor në RDGj demonstrata e së hënës, më 9 tetor 1989, ishte data historike kyçe. Shëmbja e regjimit të SED-së u krye faktikisht më 9 nëntor 1989, kur një deklaratë e pamenduar më parë e një funksionari të lartë të SED u dha kurajo qytetarëve të RDGj-së të kalonin Murin dhe kufirin. Me ndërtimin e Murit në vitin 1961 SED-ja filloi të humbiste dalëngadalë pushtetin e saj që e kishte fituar në vitet 1940-të. Me rënien e këtij Muri ajo e humbi përfundimisht këtë pushtet.

Përktheu nga gjermanishtja Astrit IBRO

Muri i Berlinit në botë

Dr. Anna Kaminsky

Edhe pse me revolucionet dhe revoltat e filluara në vitin 1989, Evropa i ka kapërcyer në një shkallë të gjërë diktaturat komuniste, ende sot në shumë nga këto vende ndeshim projekte monumentale ndërtimi që dëshmojnë për bindjen e pushtetmbajtësve të dikurshëm që regjimi i tyre do të vazhdonte të ekzistonte në përjetësi. Dëshmi të tilla janë ndërtesat gjigande të ndërtuara në kohën e Stalinit në Moskë (të ashtuquajturat pallatet e Stalinit) ose Pallati i Kulturës në Varshavë, të cilat sipas dëshirës së krerëve të pushtetit duhet dëshmonin për aftësinë, forcën dhe efikasitetin e regjimit komunist, ndonëse Pallati i Kulturës në Varshavë me hijen e madhe që lëshon(te) në qendër të Varshavës interpretohej prej popullsisë vendase në radhë të parë si shprehje e pushtimit të Polonisë dhe e nënshtrimit kulturor dhe politik të vendit nën sundimin sovjetik.

Le të kujtojmë edhe „Pallatin e Popullit“, për ndërtimin e të cilit Çausheku bëri njësh me tokën pjesën e vjetër tradicionale të Bukureshtit, pallat i cili sipas përfytyrimit të diktatorit rumun duhej të bëhej vepra më e madhe arkitekturore e botës dhe e cila përpiu një pjesë të madhe të burimeve materiale të Rumanisë.

Apo le të kujtojmë qindra-mijëra bunkerët që Enver Hoxha ndërtoi në Shqipëri për të penguar sulmet e armiqve imagjinarë, bunkerë të cilët vazhdojnë dhe sot e kësaj dite të jenë pjesë e peizazhit shqiptar. Dhe ndërsa këta bunkerë të përhapur kudo në vend vazhdojnë të dëshmojnë për paranojën e diktatorit shqiptar, njeriu kërkon më kot për ndonjë memorial, vend përkujtimor, muzem apo monument për dhjetëra-mijëra viktimat e diktaturës komuniste në Shqipëri.

Si simbol arkitekturor i diktaturës në RDGJ u shndërrua muri, i ndërtuar në 13 Gusht 1961 në mes të Berlinit. Muri i Berlinit jo vetëm ndau për 28 vjet qytetin dhe banorët e tij, por ai ndau edhe Evropën dhe botën dhe u kushtoi jetën edhe qindra njerëzve. Nga viti 1961 deri 1989 Berlini qe i ndarë me një mur 156 km të gjatë në dy pjesë: në pjesën perëndimore të qytetit të përcaktuar në bazë të marrëveshjes së aleatëve pas Luftës II Botërore, dhe në pjesë tjetër, e cila ishte nën sundimin e trupave pushtuese sovjetike. Kjo pjesë, pra Berlini lindor u bë edhe kryeqyteti i RDGJ-së, e cila u themelua në vitin 1949. Asnjë lloj ndërtimi tjetër në Gjermani dhe ndoshta madje as edhe në Evropë nuk ka pasur në gjysmën e dytë të shekullit XX një ndikim dhe pasoja kaq serioze ndaj jetës së kaq shumë njerëzve. Dhe si asnjë ndërtesë tjetër e kësaj periudhe muri u shndërrua në të gjithë botën në simbol të shtypjes dhe të diktaturës, të

përbuzja dhe marrjes nëpër këmbë të të drejtave themelore të njeriut dhe, në fund të fundit, të mbajtjes peng të miliona njerëzve nga një regjim i bazuar në padrejtësi. Njëkohësisht asnjë ndërtesë tjetër nuk u kthye kaq fort edhe në një simbol të zjarrtë i mallit për liri, i kurajos civile dhe i dëshirës për liri.

Sipas vlerësimeve në periudhën nga mbyllja e kufirit të brendshëm gjerman, në vitin 1952, dhe rënies së Murit të Berlinit e hapjes së kufirit, nga RDGJ arritën të arratisen megjithëse kufijtë ruheshin mirë, mbi 30.000 vetë. Ndërsa numri i atyre të cilët u zbuluan ndërsa bënë plane për t'u arratisur, të cilët i spiunuan apo i tradhëtuan, i atyre që u arrestuan, u plagosën shpesh rëndë në përpjekje e sipër për të arritur lirinë apo madje që e paguan këtë me jetën e tyre shkon në disa qindra e mijëra. Vetëm në Murin e Berlinit kanë humbur jetën e tyre të paktën 128 vetë. Në kufirin e brendshëm gjerman, kjo shifër shkon në mbi 1.000.

Sot si në Berlin si në zonën e dikurshme të ish-kufirit të brendshëm gjerman, vështirë se mund të gesh ndonjë gjë që të kujtojë kushtet reale të kufirit, i cili deri në vitin 1989 e bënte çdo përpjekje për të ikur një ndërmarrje të rrezikshme. Kufiri prej 156 kilometrash, që ndante dikur banorët e këtij qyteti, e që përbëhej nga 54.000 segmente betoni 2,6 ton të rëndë dhe 3,2 metra të lartë, nga qindra kilometra tela me gjemba, qindra kilometra segmente rruge të ndriçuara me prozhektorë të fortë, që ruhej nga qindra qenë kufiri dhe 186 kulla vrojtimi, prej të cilave rojet e kufirit qëllonin me armë zjarri, u zhduk në vitin 1990 brenda pak muajsh. Në shumicën e rasteve, blloqet e betonit që përbënin murin u copëtuan dhe u përdorën për të ngritur bazamentet për ndërtimin e rrugëve të reja apo për riparimin e atyre ekzistuese. Një ironi e bukur e historisë është se betoni i Murit të Berlinit është përdorur për ndërtimin e autostradave të reja që lidhin sot Gjermaninë Lindore dhe atë Perëndimore.

Po ka edhe më shumë se 600 blloqe të Murit të dikurshëm të Berlinit që gjenden sot në mbi 40 vende të botës, ku kanë gjetur një përdorim të ri si pjesë e më shumë se 140 monumenteve. Ato janë njëkohësisht si trofe të Luftës së Ftohtë, edhe simbole të fitores dhe përmendore të lirisë. Përveç përdorimit të pjesëve të Murit të Berlinit për vlerën e tyre ideale si pjesë monumentesh përkushtuar asaj periudhe, ato janë kthyer edhe në objekt tregtie dhe objektet spekulimesh në duart e disa njerëzve të shkathët që kanë bërë biznes me pjesët e murit.

Që më 10 nëntor 1989, kur muri nuk kishte as 24 orë që ishte hapur, qeverisë së Gjermanisë Lindore i arriti kërkesa e parë e një biznesmeni nga Bavaria. ¹ Ky pyeste nëse ishte e mundur që të bliheshin kundrejt devizave pjesët e fortifikimeve kufitare që kishin dalë tashmë jashtë përdorimit. Edhe misionet diplomatike të Gjermanisë Lindore në vende të ndryshme njoftonin se nga këto vende ishte shprehur interes për blerjen e pjesëve të Murit të Berlinit.

Në radhët e udhëheqjes së partisë SED kërkesa të tilla shkaktuan pasiguri dhe konfuzion. Së pari, sepse sundimtarët vazhdonin në atë kohë ende që të besonin se hapja e kufijve ndoshta mund të prapësohej, dhe se hapja e kufirit ishte vetëm e përkohshme. Së dyti, sepse mbyllja e kufijve, ndërtimi i Murit dhe regjimi çnjerëzor kufitar në mes të Evropës kishte shkaktuar gjithmonë protesta në botën perëndimore. Objektivi i RDGJ-së për t'u njohur dhe pranuar në arenën ndërkombëtare ndeshte në mënyrë të përsëritur në një qëndrim jo dashamirës dhe armiqësor, gjë që lidhej me ndërtimin e murit dhe të vrrarët në kufi. Thuajse asnjë burrë shteti nga bota perëndimore, i cili ka qenë për vizitë në qytetin e ndarë, nuk largohej pa kërkuar prej sundimtarëve të Berlinit lindor që ta prishnin murin dhe t'i jepnin popullit lirinë e vet. Në vitin 1962, presidenti i SHBA-së, Xhon F. Kenedi, e shprehu solidaritetin e tij me qytetin e ndarë me shprehjen "Ich bin ein Berliner" – Unë jam berlinez. Në vitin 1987 Ronald Reagan i bëri thirrje Sekretarit të PK të Bashkimit Sovjetik, Mihail Gorbaçov: "Mister President, open this Gate. Tear down this Wall" – "Zoti President, hapeni këtë portë. Shëmbeni këtë mur. "

Meqenëse qeveria e Gjermanisë Lindore kishte ndjerë deri tani, sidomos urrejtjen e njerëzve që ishin bllokuar në pjesën perëndimore të qytetit, dhe i kishin shkëputur dhe ndarë nga familjet dhe miqtë e tyre në Lindje apo urrejtjen e gjermanolindorëve të mbyllur pa asnjë shpresë e shans për të shpëtuar, si dhe në të njëjtën kohë ishte përballur me një izolim në arenën ndërkombëtare dhe akuzat për vrasjet në kufi, ajo ndjehej e hutuar nga interesi i papritur për blerjen e pjesëve të Murit të Berlinit.

E ndërsa qeveria e Gjermanisë Lindore vazhdonte të ishte e tronditur dhe e mbingarkuar nga ngjarjet dhe zhvillimet që po ndiqnin me furi njëra-tjetrën, populli kishte kohë që u ishte drejtuar simboleve të urryera të ndarjes çnjerëzore. Që nga 10 nëntori 1989 njerëzit shkonin me vegla, si dalta apo çekiçë, tek muri në anën perëndimore dhe shkëpusin pjesë nga trupi i "murit të turpit". Për ata u krijua një emër i veçantë: "qukapikët e murit". Copat dhe

¹ Në lidhje me biznesin me pjesët e murit krh. shkrimin e Ronny Heidenreich „Beton zu Geld. Das Geschäft mit der Berliner Mauer. Në: Die Berliner Mauer in der Welt. bot. Von Anna Kaminsky, 2009, Berlin, fq. 236 – 250. Në vijim : Heidenreich 2009

fragmentet e shkëputura nga muri u shndërruan shumë shpejt në suvenire të preferuara për vizitorët e Berlinit.

Nisur prej prishjes së pandalshme të murit, një kompani nga Gjermania Perëndimore i sugjeroi në një letër drejtuar më 14 Nëntor 1989, pra pesë ditë pas hapjes së murit, Misionit të Përhershëm të RDGJ-së në Bon, që për shkak të tregtisë së pandalshme me pjesë të Murit të "[...] megjithë [...] qëndrimin e dyjëzuar duhet të mbajë parasysh megjithatë një aspekt: Me pjesët e murit bëhet tregti, pavarësisht nga e kanë burimin. Dhe në qoftë se është kështu ne mendojmë se do të ishte me vend që prej murit të nxirren para në valutë të huaj.”²

Në radhët e popullsisë së RDGJ-së planet për shitjen e murit ishin tepër të diskutueshme. Dhe për këtë edhe qeveria e Gjermanisë Lindore, e cila ishte tashmë e vendosur që me blloqet e betonit të bënte para, e ndjeu veten të detyruar që për Krishtlindjet e vitit 1989, t’u drejtohej njerëzve përmes një fushate për shtyp dhe t’u shpjegonte se përse muri duhej shitur? Në të thuhej se Muri është pronë publike, gjë që shumë prej atyre që kishin jetuar të mbyllur për vite të tëra në RDGJ dhe nuk kishin pasur mundësi të largoheshin nga vendi, duhet t’u jetë dukur si tallje.

Qytetarëve u premtuhej se të ardhurat nga shitja e Murit do t’u viheshin në dispozicion qytetarëve të RDGJ-së për projekte humanitare, si p.sh. për projekte për përmirësimin e shërbimit mjekësor. Së fundi, thuhej edhe se RDGJ-ja kishte urgjentisht nevojë për deviza dhe valutë të huaj. Në janar 1990 qeveria e Gjermanisë Lindore vendosi më në fund "shfrytëzimin komercial të të gjitha segmenteve të fortifikimeve të kufirit ("murit)," gjë që u miratua zyrtarisht në takimin e kabinetit më 04.01.1990.³

Për çmontimin e rregullt të murit u bënë përgjegjës pikërisht ata që deri në atë moment kishin bërë roje në shërbim të asaj diktature që kishte ngritur atë mur dhe që përpjekur për të shtypur pa mëshirë dhe në mënyrë konsekuente të gjitha përpjekjet e atyre që donin të largoheshin. Edhe ligji për të hapur zjarr ndaj atyre që donin të kalonin kufirin u shfuqizua zyrtarisht vetëm më 21. 12. 1989, dmth. pra më shumë se gjashtë javë pas rënies së Murit të Berlinit. Trupat

² Teleks i firmës M. A. Unternehmensberatung drejtuar Misionit të Përhershëm të RDGJ-së në Bon, 14.11.1989. BArchB DE 10/21 cituar sipas Heidenreich 2009, fq. 236.

³ Vendim i Këshillit të Ministrave të RDGJ 8/1.8./90 dt. 29.11. 1989 për përdorimin për qëllime komerciale të sementeve të tëra apo pjesëve të sistemit të sigurimit të kufirit ("Murit") me Berlinin Perëndimor. BArchB DC 20/1/3 2891. Cituar sipas Heidenreich 2009.

kufitare, sidomos qendra e komandës kufirit, ishin tani përgjegjëse për largimin e shpejtë të fortifikimeve të kufirit, gjë që përfundoi plotësisht më 30 nëntor 1990.

Veçanërisht fitimprurëse ishte shitja e pjesëve të pikturuara të murit. Por në mur njerëzit mund të pikturonin vetëm në pjesën perëndimore, pasi nga Lindja nuk lejohej njeri t'i afrohej murit pa vënë në rrezik jetën e vet. Banorët e pjesës lindore të Berlinit mund të shihnin vetëm të ashtuquajturin "pjesa e brendshme e murit", apo rrethimin e parë, i cili pasohej nga një zonë vdekjeje, nga vendet e bllokimit të tankeve, nga llogore për pengimin e automobilëve dhe nga elemente të tjera të vijës kufitare. Në mënyrë të veçantë këtu duhen përmendur rreth 300 metrat e murit në qendër të Berlinit mes lagjes Kreuzberg dhe Mitte në të cilën kishin pikturuar artistë të famshëm si Thierry Noir, Kiddy Ciny apo Keith Haring dhe Jürgen Grosse alias "Indiano". Një pjesë muri e pikturuar prej këtij të fundit gjendet për shembull përballë Muzeut Mbretëror të Luftës në Londër, duke qenë në lidhje të drejtpërdrejtë me eksponatet e vendosura në këtë ekspozitë rreth konflikteve të lindura pas Luftës II Botërore pra nga viti 1945. Prej pjesësh të tilla qeveria e re e RDGJ-së e zgjedhur në mënyrë demokratike nën drejtimin e Lotar de Maiziere shpresonte të gjeneronte të ardhura.

Sot pjesë të Murit të Berlinit i gjen nga Kanadaja në Afrikën e Jugut, nga Shtetet e Bashkuara në Japoni, nga Meksika në Honolulu dhe Australi, nga Vatikani në vendin e peligrinazhit Fatima në Portugali e deri në një nevojtoare publike në Las Vegas. Motive dhe piktura nga Muri i Berlinit gjenden madje edhe si motive për mbulesa krevati apo dyshekë.

Ndër pronarët e rinj të pjesëve nga Muri bëjnë pjesë Bill dhe Hillary Clinton, Papa, Bill Gates dhe Hans Olaf Henkel ose firma TÜV Rheinland në Japoni. Në Gjermani pjesë të murit janë të vendosur si përmendore për të kujtuar vlerën e lirisë dhe demokracisë dhe tejkalimin e diktaturës në shumë qytete të tilla si Salzgitter, Rostock, Rastatt apo Pforzheim.

Shpesh, vendet e reja ku janë ekspozuar pjesë të murit kanë një karakter simbolik, si p.sh. përpara Qendrës për të Drejtat e Njeriut "Saharov" në Moskë. E veja e Andrei Saharovit, disidentit sovjetik dhe fituesit të çmimit Nobel, Jelena Boner, u përpoq të siguronte një pjesë të murit që në vitin 1990. Kësaj ajo ia doli mbanë në vitin 1996, me rastin e 5-vjetorit të themelimit të qendrës. Tre artistë rusë - Aleksei Grigoriev, Daniel dhe Maksim Mitljanskij – e kanë shndërruar këtë pjesë fillimisht të papikturuar të murit në një "Monument për Lirinë".

Një vend i veçantë ekspozimi të një pjese të murit është në Fatima (Portugali). Në këtë vend të shenjtë pelegrinazhi të katolikëve, thuhet se në vitin 1917 u është shfaqur tre fëmijëve

barinjsh virgjëresha Mari (Shën Mëria), e cila u ka shpallur tri profetësi. Ndërsa dy prej tyre, ajo që kishte të bënte me Luftën e Dytë Botërore, dhe ajo që kishte të bënte me rrëzimin e komunizmit, janë bërë publike që në vitin 1942, profetësia, që lidhej me atentatin ndaj Papës në vitin 1981, u mbajti sekret deri në vitin 2000. Fuqia simbolike e këtij vendi duket edhe në faktin, që gjatë demonstratave kundër sundimit komunist në Poloni, Hungari dhe Çekosllovakia demonstruesit mbanin në dorë statuja të virgjëreshës Shën Mëri nga Fatima. Më 03.04. 1991, Papa Gjon Pali II e bekoji pjesën e murit që gjendet në Fatima.

Pjesa e Murit që ndodhet në Seul, kryeqytetin e Koresë së Jugut, e cila u përrua më 28.09. 2005 në Sheshin "Berlini" të Seulit, është një dhuratë nga qyteti i Berlinit për qytetin partner të Seul dhe simbolizon shpresën për bashkimin e Koreve.

Së fundi përkujtimi i rënies së Murit të Berlinit ka arritur deri në Mars. Misioni "Pathfinder" përcolli në vitin 1997 imazhet e para nga Marsi. Gjeologu gjerman, Ralf Jaumann, propozoi që një nga formacionet e ndryshme shkëmbore të Marsit të quhej "Broken Wall" –"Muri i thyer" për të përkujtuar datën 09.11.1989. Misionet e mëpasshme në planetin Mars e kanë rimarrë këtë ide. Dhe sot në Mars nuk kemi vetëm një formacion në kujtim të Murit të Berlinit, por me edhe të tillë me emra si "Kisha Shën Nikollës," "Demonstratat e së hënës" dhe "Bashkimi" në përkujtim të guximit të qytetarëve që dolën në demonstrata në vjeshtën e vitit 1989.

E ndërsa Muri konsiderohej pas rënies si diçka me vlerë për t'u përkujtuar në të gjithë botën, pas kësaj ngjarjeje ai ra në Berlin disi në harresë për shkak të problemeve më të ngutshme aktuale që dilnin në plan të parë. Sado e kuptueshme është dëshira e atëhershme dhe përpjekjet për ta kthyer qytetin e ndarë në normalitet dhe për të eliminuar sa më shpejt të ishte e mundur plagët e së kaluarës, largimi pothuajse i plotë i pjesëve të murit nga rrugët apo parqet e Berlinit përmbante edhe rrezikun e zbehjes nga kujtesa dhe nga përfytyrimet të asaj çfarë do të thoshte ky mur jo vetëm për qytetin dikur të ndarë, por edhe për vendin, për Evropën dhe botë. Por, si edhe në disa raste të tjera, Muri u kthye në Berlin në mënyrë të tërthortë. Ndërsa reliktet e tij po gjenin rrugën përreth globit duke triumfuar në formë monumentesh, сувениresh ose thjesht duke u përdorur për destinacionin e tyre fillestar – elementet e betonit ishin konceptuar fillimisht për ndërtimin e silove bujqësore –gjithnjë e më shumë njerëz dhe vizitorë që vinin në Berlin pyesnin të çuditur: Po muri, ku është?

Sidomos për viktimat e Murit të Berlinit, për ata që e kishin paguar angazhimin e tyre për demokraci dhe të liri me burg dhe me persekutim, apo për ata që kishin humbur ndonjë të afërm mungesa e një vendi përkujtimor të dukshëm dhe publik, e një vendi të përshtatshëm për të mbajtur zi në kujtim të krimeve dhe të shkeljes së të drejtave që kishin ndodhur në Berlin, ishte e vështirë për t'u pranuar. Në vitin 2004 drejtuesja e muzeut në pikëkalimin Checkpoint Charlie, organizoi një aksion përkujtimor duke vendosur më shumë se 1.000 kryqe prej druri në zonën përreth Checkpoint Charlie. Kryqet ishin një shenjë përkujtimi për ata që kishin lënë jetën në përpjekje për të kaluar Murin dhe synonin të vinin në dukje se deri tani në kryeqytetin gjerman mungonte një ndonjë vend përkujtimor qendror, publik dhe i dukshëm për Murin dhe viktimat e tij. Edhe pse në vitin 2005 instalacioni me kryqet u hoq, ai e kishte bërë punën e vet duke shërbyer edhe një sinjal për bashkinë dhe autoritetet e tjera të Berlinit. Ato zhvilluan një koncept për mënyrën se si mund të përkujtohet dhe të shihet se çfarë ishte Muri i Berlinit dhe vendosën të ngrenë një qendër përkujtimore në rrugën Bernauer Strasse, e cila dikur ndahej nga Muri. Edhe festimet zyrtare për 50-vjetorin e Murit më 13 gusht 2011, ditë në të cilën Kancelarja gjermane, Presidenti, Kryetari i Bundestagut si dhe ministra dhe deputetë vizituan së bashku me të persekutuar nga diktatura, me familjet e tyre dhe mijëra berlinezë edhe qendrën përkujtimore në rrugën Bernauer Strasse, treguan shumë e qartë se plagët e ndarjes së dikurshme dhe kujtimet për padrejtësitë që kishin ndodhur, jo vetëm ishin ende gjallë në kujtesën e njerëzve dhe duhen mbajtur të tilla.

Monumentet e ngritura në kujtim të Murit të Berlinit janë ndonjëherë patetike, ndonjëherë heroike madje edhe kitsch (kiç) – gjithësesi ato janë thjesht përmendore prekëse dhe mbresëlënëse për të tërhequr vëmendjen që edhe ajo që nuk pritet mund të ndodhë, dhe se ne nuk duhet ta pranojmë dhe durojmë shtypjen, mungesën e lirisë dhe diktaturën. Në këtë formë ato janë monumente elementare për të gjithë ata që mundën frikën dhe kërcënimin që u kanosej dhe u ngritën kundër një regjimi në dukje të palëkundshëm dhe të plotfuqishëm dhe kjo jo vetëm në vjeshtën e vitit 1989 dhe jo vetëm në Gjermaninë Lindore.

Diktatura në Shqipëri, veçoritë dhe anët e përbashkëta me diktaturat e tjera dhe regjimet totalitare

Dr. Pandeli Pani

„I gjithë vendi është si një oborr i mbyllur, i rrethuar nga mure natyrale burgu, liria është një nocion relativ (...) njeriu ndjen se anijet dy orë, katër orë, dymbëdhjetë orë larg prej këtu, qëndrojnë në një port shqiptar vetëm një herë në jaër, dhe ekzotika peshon dy herë më vrazhët se vetë tortura e vetëpërzgjedhur“; edhe pse këto radhë mund të shërbenin më së miri për të përshkruar Shqipërinë komuniste, ato janë nxjerrë nga një reportazh i Jozef Rot (Joseph Roth), botuar në Frankfurter Zeitung në vitin 1927.

Gjendja e përshkruar nga Roth u bë më e fortë gjatë 50 viteve të diktaturës që ndiqte një politikë autarkike, e cila e izoloi hermetikisht dhe në mënyrë të ndërgjegjshme Shqipërinë nga bota e jashtme, madje edhe nga vendet socialiste, me qëllim që të mund t’i sundonte njerëzit më mirë. Në këtë mënyrë „Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë“ u bë një vend periferik notorik; asnjë vend tjetër në Evropë nuk u izolua më shumë se Shqipëria. Izolimi vlente edhe ndaj popullsisë shqiptare në ish-Jugosllavi. Sikurse ka konstatuar me të drejtë Robert Elsie, *„kufiri midis dy gjysmave të kombit shqiptar ishte mbyllur nga sunduesit e tyre respektivë (...) dhe krahasuar me këtë kufi Muri i Berlinit midis dy pjesëve të Gjermanisë ishte një shoshë“*⁴.

Si në shumicën e shteteve evropianolindore edhe në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore pushtetin e mori Partia Komuniste. Njësoj si në shtetet e tjera të bllokut sovjetik edhe komunistët shqiptarë, krijuan sipas modelit stalinist, përveç instrumenteve tradicionalë edhe instrumenta të rinj sundues, të cilët u shërbenin për plotësimin e disa nevojave njëkohësisht: a) për ushtrimin e një pushteti të pakufizuar dhe të pakontrolluar, b) për krijimin dhe mbajtjen e instancave legjitimuese dhe c) së fundmi edhe për nevojat e ushtrimit të terrorit për të trëmbur popullsinë.

⁴ Robert Elsie, Histori e letërsisë shqipe dhe kulturës letrare shqiptare, Mynih 2009: 222

Por Shqipëria në zhvillimin e saj shfaq disa karakteristika që devijojnë nga tipi i „demokracive popullore“ evropianolindore si në politikën e brendëshme, ashtu edhe në politikën e jashtme.

- a) Ekspertët e Evropës Lindore janë të mendimit se diktatura komuniste në Shqipëri ishte më e ashpra dhe më e pamëshirëshmjia në Evropë⁵. Çdo gjurmë e lëvizjes opozitare, sado e vogël që të ishte, u ndoq me ashpërsi, u shtyp dhe u mbyrt që në embrion. Tipike për Shqipërinë ishin tërmetet politike periodike, në formën e fushatave spastruese gjithëpërfshirëse, viktimat të cilave nuk ishin vetëm „armiqtë e popullit, personat me bindje armiqësore apo elementët antiparti“ – si thuhej në zhargonin e komunist, por edhe i gjithë rrethi i tyre familjar.

Feja në të gjitha vendet e ish-blokut sovjetik u konsiderua si armik i shtetit. Ndërsa Shqipëria i lau përfundimisht hesapet me fenë që në vitin 1967. Në vitin 1976 ateizmi u sanksionua madje edhe formalisht në kushtetutë (neni 37)⁶.

Mbas vdekjes së Stalinit Hoxha shmangu me këmbëngulje çdo përpjekje për çrrënjosjen e kultit të Stalinit dhe destalinizim, duke kundërshtuar vrullshëm kërkesat e Moskës dhe Beogradit për një rehabilitim të viktimave nga koha pas prishjes me Titon⁷. Me sa duket Hoxha duhet të ketë patur frikë se një hap i tillë mund të ishte fillimi i përmbysjes së atij vetë. Madje PPSH mbrojtjen e „Stalinit dhe veprës së tij

⁵ Në një popullsi prej 3 milionë banorësh për arsye politike janë ekzekutuar të paktën 5157 vetë, ka pasur së paku 17.900 të burgosur politikë, 30.383 të tjerë u syrgjynosën për shkaqe politike në kampet e internimit ose u dërguan me detyrim për të punuar për dekada të tëra në fshatra të largët, duke iu ndaluar madje edhe të kishin kontakt me banorët e tjerë të fshatit. Në kushte të tilla mungonte vetëm mbajtja e detyrueshme e ndonjë shenje dalluese, si „ylli i çifutëve“.

⁶ Shtypja e të gjitha komuniteteve fetare, edhe pse me një ashpërsi të diferencuar, kishte filluar qysh me marrjen e pushtetit nga komunistët. Sipas pikëpamjes së Enver Hoxhës kisha katolike ishte shumë më e rrezikshme për regjimin se sa feja islame apo kisha ortodokse. Edhe në direktivat e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë udhëzohej që lufta kundër fesë të bëhej e diferencuar sipas feve të ndryshme (krahaso: Historia e PPSH; faqe 493). Por përjashtimi përfundimtar erdhi me fjalimin e Enver Hoxhës më 6 shkurt 1967, kur Hoxha sipas shëmbullit të Kinës nisi një revolucion kulturor shqiptar dhe bëri thirrje për të larë përfundimisht hesapet me fenë. Për këtë u përdor në një mënyrë shumë perfide fjalia e nxjerrë nga poezia e Pashko Vasa's e vitit 1880: „Mos shikoni kisha e xhamia, feja e shqiptarit është Shqiptaria“, fjali kjo e nxjerrë komplet nga konteksi e cila u keqpërdor si thirrje për betejë kundër fesë. Qysh në maj 1967 regjimi e shpalli Shqipërinë si shteti I parë ateist në botë. 2.169 xhami, kisha, manastire, faltore dhe institucione të tjera fetare u grabitën, u mbyllën ose u kthyen gjatë kësaj kohe në depo, qendra kulture apo pallate sporti. Piktura të çmuara, ikona me vlerë si dhe shumë dokumenta arkivore e libra u shpallën si “mall fetar pa vlerë”, duke u bërë kështu prehë e asgjësimit” (krahaso: Zef Pëllumbi, Historia e vërtetë e Shqipërisë: Si e shkatërruan komunistët arkivin. Në *Shqipëria midis kryqit dhe gjysëmshënës*, Werner Daum (bot.), Mynih 1998, faqe 315). Shumë klerikë u futën në burg, ku më pas u ekzekutuan apo gjetën vdekjen, të tjerë u dënuan menjëherë. Madje edhe formula “(betohem) për Zotin” u zëvendësua me “(betohem) për ideal të Partisë”, duke gjetur përdorim edhe në gjuhën e përditshme.

⁷ Është fjala për si Koçi Xoxen, ish-ministër i Brendshëm dhe zëvendës i Hoxhës, i cili pas prishjes me Jugosllavinë u ekzekutua, edhe për pasuesit e tij, të ashtuquajturin grupi i Koçi Xoxes.

nga sulmet, denigrimet dhe falsifikimet e revizionistëve modernë“ e bëri një nga detyrat e saj më të rëndësishme. Por ndryshe nga sa propagandohej, kulti i Stalinit, ashtu sikurse edhe ideologjia leniniste nuk ishin për Hoxhën dhe udhëheqjen shqiptare çështje parimesh, por një instrument i pastër sundimi dhe një mjet për të justifikuar mbajtjen e pushtetit.

- b) Në aspektin e politikës së jashtme Shqipëria gjatë historisë së saj komuniste ka befasuar shumë herë miq dhe armiq, duke ndërprerë lidhjet me fuqitë e saj mbrojtëse, pa marrë parasysh sanksionet ekonomike apo rreziqet politike. Në këtë mes nuk ishte ndonjë gjë e rrallë, që miku më i mirë deri sot, të nesërmen të shndërrohej në armikun e betuar. Të gjitha prishjet me aleatët e dikurshëm nga kampi socialist trumbetoheshin me të madhe si mbrojtje e marksizëm-leninizmit, të shoqëruara me parrullën: „Shqiptarët më mirë hanë bar, se të heqin dorë nga parimet e tyre dhe të tradhëtojnë marksizëm-leninizmin“. Por si në konfliktin midis Beogradit dhe Tiranës pas konfliktit Tito-Stalin ashtu edhe gjatë prishjeve të mëvonëshme me Bashkimin Sovjetik dhe Kinën, në radhë të parë ishte fjala për pushtet dhe pastaj për ideologji. Të gjitha këto lëvizje taktike i shërbenin ruajtjes së pushtetit të elitës politike shqiptare. Më e qartë bëhet kjo po të shohim se çdo prishje me mbrojtësit dhe aleatët e mëparshëm – në gjuhën zyrtare nuk bëhej fjalë për prishje, por për një „betejë të fituar kundër armiqve të Shqipërisë“ – shoqërohej nga fushata spastrimi gjithëpërfshirëse. Në „zjarrin e revolucionit“ – ose thënë më mirë në “zjarrin përvëlues të ferrit të diktaturës” – u eliminuan pa hezitim dhe pa kompromis ata që shpalleshin kundërshtarë të politikës së brendëshme.

Pavarësisht këtyre dallimeve në sistemet dhe jetën e përditëshme në Shqipëri dhe në vendet e tjera të bllokut lindor (për shëmbull në Bashkimin Sovjetik dhe RDGj) gjenden edhe shumë elemente që mund të krahasohen. Karakteristika të njëjta gjejmë madje edhe në diktaturat e tjera, p.sh. në diktaturën gjermane të kohës së nazizmit, ose në fashizëm, si në kohën e Musolinit në Itali⁸. Ky fakt është i lidhur me bërthamën e përbashkët të sundimeve totalitare, pra përpjekjes për sundim absolut, të pakontrolluar, për pushtet të centralizuar, universalist dhe për kontroll totalitar. Vetëm veshja e sistemeve të tilla varion sipas kontekstit.

⁸ Mund të vërejmë se fashizmi Italian nuk zhvilloi ndonjë terror të krahasueshëm me atë të Bashkimit Sovjetik apo të nacionalsocializmit gjerman. Përveç kësaj në fashizëm – si dhe në nacionalsocializëm – nuk ka pasur ekonomi të planifikuar dhe të drejtuar nga shteti.

Ndër karakteristikat e përbashkëta mund të përmenden:⁹

- Prania masive e një partie të vetme, e cila përjashton të gjitha të tjerat, e cila ndikon të gjithë jetën e njerëzve si dhe parimi i udhëheqësit¹⁰
- Mungesa e ndarjes së pushteteve dhe i një drejtësie të pavarur
- The dual state (Ernst Fraenkel), dualizimi i të gjithë posteve dhe institucioneve nga partia
- Vendosja në një shinë të përbashkët e mediave dhe instrumentalizimi i plotë i kulturës, i jetës shpirtërore nga partia shtet dhe „spastrimet“ për këto qëllime¹¹
- Përparësia e aksionit para programit, i ashtuquajturit revolucion i vazhdueshëm dhe i pandërprerë¹²
- Premtimi për siguri sociale dhe ekonomike
- Keqpërdorimi i politikës sociale për të zëvendësuar liritë qytetare
- Argumentimi gjoja demokratik
- Instalimi i policisë sekrete dhe depërtimi i policisë sekrete në të gjitha fushat e jetës
- Psikologjia e luftës, një politikë mbi bazën e skemës mik-armik, krijimi i figurave demagogjike për armikun, fanatizmi dhe radikaliteti
- Kulti i rinisë
- Mobilizimi vazhdueshëm i masave dhe i organizatave të masave; „detyrimi vullnetar“ për pjesëmarrje dhe anëtarësi
- Një ekonomi e drejtuar nga shteti

⁹ Në lidhje me karakteristikat e pranishme në të gjitha llojet e diktaturave dhe të sistemeve totalitare, krahaso Sigmund Neumann, Permanent Revolution. The Total State in a World at War, New York 1942; Ernst Fränkel, The Dual State. A Contribution to the Theory of Dictatorship, New York 1941; Carl J. Friedrich, The Unique Character of Totalitarian Society, në: Idem. (Bot.) Totalitarianism, Cambridge/Mass, 1945, faqe 47-60; Carl J. Friedrich/Zbigniew K. Brzezinski, Totalitarian Dictorship and Autocracy, Cambridge/Mass. 1954; Hannah Arendt, Elemente dhe prejardhja e sundimit totalitar, Mynih 1965; Mbi kuptimin e konceptit të totalitarizmit, krahaso Clemens Vollnhals APuZ 39/2006. Vërehet se të përbashkëta dhe përputhje midis diktaturave të kallëpit stalinist dhe atyre të nacionalsocializmit konstatohen vetëm në drejtim të strukturës së sistemeve sunduese dhe jo në drejtim të arsytimit apo të qëllimeve ideologjike të tyre.

¹⁰ „Parimi i udhëheqësit“ vllente si ligj themeltar i botëkuptimit nacionalsocialist. Ai i obligonte njerëzit që të vepronin sipas motos „udhëheqësi urdhëron, ne e ndjekim pas“, pra ata duhet të ishin të bindur verbërisht dhe t'i qëndronin besnik pa kushte Hitlerit si „udhëheqësi“ suprem, si dhe të ndiqnin respektivisht në mënyrë të verbër urdhërat e udhëheqësve të nivelit të mesëm dhe të poshtëm. Krahaso: Ç' *thotë Partia bën populli!*“ Edhe në drejtshkrimin e gjuhës shqipe fjala Parti duhej të shkruhej me të madhe.

¹¹ Krahaso. Pandeli Pani, “Ne në gojë të ujkut hedhim valle ... “ – Shqipëria komuniste dhe armiqtë e saj kapitalistë dhe revizionistë, në Satjukow/Gries (Bot) Armiqtë tanë – konstruksionet e tjetrit në socializëm, faqe 527-541, ketu faqe 537.

¹² Krahaso nenin 4 të kushtetutës shqiptare të vitit 1976 „Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë ndjek një politikë të revolucionit të vazhdueshëm duke iu përmbajtur parimit të luftës së klasave“.

Në këtë shkrim nocionet diktaturë dhe regjim totalitar apo shtet totalitar janë përdorur pak a shumë si sinonime, edhe pse në studimet e detajuara me sfond politik bëhen dallime midis despotisë/despotizmit, autokracisë, tiranisë, diktaturës (autoritare, terroriste) dhe totalitarizmit. Por një paraqitje e hollësishme e dallimeve të këtyre nocioneve dhe përcaktimeve terminologjike do ta kapërcente kuadrin e kësaj kumtese¹³.

Megjithatë dëshiroj të ndriçoj pak më nga afër tri karakteristika të këtyre sistemeve, me të cilat janë marrë më nga afër ndër të tjerë Carl Joachim Friedrich dhe Hannah Arendt në kerkimet dhe studimet e tyre mbi totalitarizmin dhe sistemet totalitare, sepse ato, sipas mendimit tim, janë shumë të goditura kur është fjala për përshkrimin dhe klasifikimin e diktaturës shqiptare si diktaturë totalitare.

- Njëri nga dallimet midis një diktature njëpartiake “si një formë moderne e tiranisë” dhe e *diktaturës totalitare apo sundimit totalitar*, të cilën Arendt e ka cilësuar si “më të frikshmen e të gjitha formave moderne të qeverisjes” qëndron në faktin, se terrori, dhuna ekstreme dhe asgjësimi nuk drejtohen vetëm kundër armiqve të sprovuar të regjimit, por edhe kundër *personave apo grupeve të popullsisë të klasifikuar si të tilla në mënyrë arbitrare*. Këtu është fjala për qindra e mijëra të burgosur politikë dhe persona të tjerë, të cilët për arsye politike u dërguan në kampet e internimit ose u dënuan të jetonin për dekada të tëra në fshatra të largëta. Është fjala për përndjekjen e familjes së personit që dënohej deri te kushërinjtë e shkallës së dytë apo të tretë; për fëmijët e të internuarëve që lindën në kampet e internimit apo në zonat e internimit, të cilët cilësoheshin qysh para lindjes si armiq të regjimit, apo për familje të tëra deklaroheshin si “familje armiku” apo „me njollë në biografi, me biografi të keqe“ etj. Këtu duhen përmendur edhe rastet e atyre që dënoheshin rëndë, edhe vetëm sepse ishin dashuruar me pjesëtarë të familjeve të atyre që ishin cilësuar si “armik i klasës apo ishin martuar me persona nga radhët e tyre. Nga një lidhje e tillë mund të shtoheshin vetëm armiq të socializmit. Në këto rrethana mbajtja e detyrueshme e një ylli çifuti nuk do të kishte qënë shumë larg.

Komunistët shqiptarë përcaktuan menjëherë pas marrjes së pushtetit, se cilët ishin armiq të brendshëm të popullit: kriminelët e luftës, pronarët e mëdhenj të tokave (bejlerët), tregëtarët e prekur nga reforma komuniste e shpronësimit, intelektualët reaksionarë dhe spiunët – si të tillë u cilësuan edhe klerikët – gratë e pamoralshme, me

¹³ Krahaso për këto hollësi literaturën në shënimin 6.

një fjalë “ gjithë fundërinat e shoqërisë”.¹⁴ Nën moton “e thellimit dhe të intensifikimit të vazhdueshëm të luftës së klasave” – një nocion që me sa duket u shpik në gjuhën e komuniste si eufemizëm „për terrorin e pastër“ – u ekzekutuan dhe ishin në rendin e ditës shumë dënime me apo pa proces gjyqësor. Nga terrori nuk ishin të mbrojtur as bashkëluftëtarët e dikurshëm të Hoxhës dhe luftëtarët e rezistencës, si dhe antarët e partisë së vetme sunduese PPSH-së.

Në raportin me rastin e kongresit të 7-të të PPSH-së thuhet: “Partia dhe diktatura e proletariatit i goditën ata (armiqtë e popullit) me grusht të hekurt dhe i hodhën në koshin e plehrave të historisë, atje ku e kanë vendin të gjithë tradhëtarët e revolucionit. E pastruar nga këto ferra dhe barëra helmuese Partia doli nga kjo luftë më e fortë dhe më e bashkuar.”¹⁵ Spastrimi i elementeve të përmendur më sipër që konsideroheshin si armiq të socializmit vazhdoi deri në përmbysjen e komunizmit duke u plotësuar vazhdimisht me elemente dhe nuanca të tjera (liberalizmi, shfaqjet e huaja etj).

- Një karakteristikë tjetër e aparatit sundues totalitar është ajo që Arendt e quan „*mungesa e strukturës*” apo që Ernst Fraenkel e quan “*the dual state*” – dualizimi i të gjitha posteve dhe institucioneve nga partia. Këtu bën pjesë edhe mungesa e një drejtësie të pavarur. Madje në Shqipëri u suprimuan edhe institucioni i avokatit (në vitin 1967) dhe më pas edhe Ministria e Drejtësisë. Nga “mungesa e strukturës”, mungesa e transparencës dhe moszbatimi i ligjit, pushteti shtetëror u bë i frikshëm. Për shkak të lëvizjes permanente, e cila rivizatonte dhe përcaktonte vazhdimisht „portretet e armiqve“, çdo njeri mund të bëhej në këto kushte armik dhe viktimë. Pra në kushte tilla, kur nuk ishte e qartë se kush, kur, si dhe për cilat shkaqe mund të shpallej armik dhe të humbiste pushtetin, apo të ngrihej në pushtet; kur nuk e dije kurrë me siguri se ishte apo jo në shënjestër, të kishin vënë ose në rreth apo që për atë moment nuk i bije kujt në sy, rreziku për një sjellje të pabindur apo të papërshtatshme ishte i paparashikueshëm dhe i pallogaritshëm. Frika dhe pasiguria e vazhdueshme ishin ulur këmbë kryq, çoroditja dhe disorientimi ishin bërë gjëra të ditës dhe e bënë të pamundur veprimin njerëzor dhe ekzistencën e çdo opozite. Kësaj i shtohej edhe fakti që kur organet e shtetit të vinin një herë në shënjestër, atëherë fantazia e dyshimeve dhe e fajësimeve nga ana e tyre nuk njihje kufij.

¹⁴ Hoxha, Enver: Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë. Tiranë 1982: 425.

¹⁵ Shqipëria sot, 6/76, faqe 10.

Udhëheqësi që ishte në krye kujdesej vetë për çorientimin e ndërgjegjshëm (le të kujtojmë për shëmbull vetvrasjen/vrasjen e Mehmet Shehut dhe shpalljen e tij si poliagjent) dhe dyjëzimin e të gjitha posteve zyrtare dhe të institucioneve, pasi aty ku kompetencat e pushteteve nuk janë të percaktuara qartë, pikërisht aty udhëheqësi është i vetmi që mund të ndërhyjë dhe mund të marrë vendimin e fundit.

- Diktatura shqiptare mund të cilësohet edhe si një lloj shoqërie që Hannah Arendt e quante *shoqëria e kampeve të përqendrimit*. Po të përdorim përsëri një nocion të Ahrendt, një nga qëllimet e saj më të rëndësishme ishte shkatërrimi i “njerëzores”, pengimi i njerëzve për të qenë “*zoon politikon*”, pra shkatërrimi i aftësisë së tyre politike dhe bashkë me të edhe i aftësisë për gjykim politik dhe veprim (Arendt përdor në këtë kontekst një fjalë që është shumë e vështirë për t’u përkthyer “*das Politische*” dhe flet për “shkatërrimin e politikës”).
- Me fjalën “*njerëzore*” Arendt nuk kupton sjellejen miqësore, të përzemërt apo me respekt midis personave, por *aftësinë për të menduar, për të vepruar, për të qënë spontan, krijues dhe aftësinë për të filluar nga e para*. Kjo aftësi është ajo, që sipas mendimit të saj, përbën njeriun.

Edhe aftësimin politik të njeriut si “*zoon politikon*” Arendt e kupton në një formë të tillë, që politikja (aftësia për gjykim dhe veprim politik) nuk është diçka e vendosur te njeriu, por diçka që lind *midis* njerëzve. Duke u nisur nga pluraliteti i njerëzve, Arendt vëren se politikja dhe politika e vërtetë bëhen të mundura vetëm në këtë *hapësirë ndërnjerëzore të pluralitetit*.

Le të qëndrojmë fillimisht te shkatërrimi i “njerëzores”. Për t’i përfshirë njerëzit në procesin totalitar dhe pastaj për t’i sunduar ata përfundimisht lipset të asgjësohet me të gjitha mjetet, pra edhe me dhunë e terror, hapësira për individualitetin dhe spontanitetin njerëzor. Ajo çka Hannah Arnedt e cilëson si njerëzore, në Shqipërinë komuniste konsiderohej dhe në zhargonin komunist etiketohej si “lakra në kokë”. Si të tilla konsideroheshin shfaqet e liberalizmit, apo “gatishmëria për koncesion ndaj politikës dhe ideologjisë së armikut, tendencat për heqje dorë nga normat e moralit proletar, për një frymë pajtuese kundrejt mënyrës borgjezo-revizioniste të jetës, mungesat, dobësitë etj”.¹⁶ Po të lëmë mënjanë gjuhën e

¹⁶ Shqipëria sot, Nr. 2/78, faqe 8

ngurtë dhe të drunjtë të partisë, mund të themi se këtu bëhet fjalë për një luftë në kokat e njerëzve. Lufta drejtohej kundër kokave, kundër “qafëleshëve” apo atyre që mbain mjekër; bëhej fjalë pra një luftë kundër “barërave të këqia në kokën e atyre njerëzve” që ishin infektuar “prej pilulave të ëmbëla borgjezo-revizioniste”. Në shënjestër të kësaj lufte nuk ishin vetëm flokët e gjata apo mjekra por edhe moda: mini e maksifundet, pantallonat e shkurtëra te burrat, pantallonat apo bluzat e ngushta te gratë, të gjitha këto cilësoheshin si ekstravagante, të papranueshme, bile të dënueshme. Në rastin më të mirë pëe “devijime” apo “gabime” të tilla mund të shpëtoje me një autokritikë fshikulluese. Por ata që i thyenin vazhdimisht këto rregulla, mund t’u nënshtroheshin edhe “masave riedukuese”. Vigjilenca e regjimit ishte e pranishme edhe në mbrëmjet e vallëzimit, madje edhe në lidhjet intime apo ato të dashurisë.

Meqënëse individualiteti dhe spontaniteti njerëzor mbartënin në vetëvete vazhdimisht rrezikun e daljes nga shinat dhe në kuptimin e ideologjisë sunduese çdokush mund të shpallej fajtor, askush nuk ishte i imunizuar asnjëherë ndaj arbitraritetit shtetëror. Kjo gjëndje nuk çonte vetëm në një frikë dhe pasiguri të vazhdueshme, por ishte edhe më e tmerrshme, ajo çonte në izolimin e individit nga bota e jashtme dhe çonte në lindjen e ndjesisë së braktisjes. Kur dikush shpallej armik, të paktën në sipërfaqe të tjerët detyroheshin të distancoheshin prej tij, ta braktisnin, ta linin vetëm. Kjo ndjenjë e planifikuar braktisjeje dhe pafuqie për të ndërmarrë diçka, e cila shkaktohej në mënyrë artificiale, u bë përvoja bazë e sundimit totalitar.

Me shkatërrimin e hapësirës për individualitetin njerëzor, spontanitetin dhe marrëdhëniet ndërnjerëzore dhe me institucionalizimin e sundimit total u bë i mundur edhe asgjësimi i “botës së përbashkët ku gjenin vend të gjithë” dhe i “mendimit pa parrmakë”. Me “të menduar pa parrmakë” Arendt kupton një lloj të menduari, ku *të tjerët* janë vazhdimisht të pranishëm, pra të menduarit sipas rregullave dhe kornizave të përcaktuara ideologjike. Megjithëse i ngjeshur me gjithë të tjerët si në një kuti konserve, çdo individ mbetet i izoluar nga gjithë të tjerët. Njerëzit thekson Arendt janë të organizuar në mënyrë të tillë sikur ekzistojnë vetëm në shumës, sikur mes tyre nuk ka anjë dallim, madje nuk ka as pluralizëm, sikur ata ekzistojnë vetëm si një njësi, si një trup i vetëm, si bashkësi popullore ose si klasë punëtore. Kështu që mundësia për të marrë parasysh edhe mendimin e tjetrit humbet sikurse edhe aftësia për të mos e shpallur pikëpamjen apo mendimin tënd si të vetmin që është i drejtë, por për ta peshuar dhe krahasuar atë me pikëpamjet e të tjerëve. Prej kësaj në sundimin totalitar rezulton

sipas Arendt jo vetëm një humbje radikale e fuqisë për të gjykuar vetë, por edhe e mendjes së shëndoshë njerëzore. Njerëzit humbasin aftësinë për të gjykuar në mënyrë të pavarur, pra “për të gjykuar për gjëra të veçanta, *pa* ua nënshtruar ato rregullave të përgjithshme”. Le të kujtojmë këtu ritualet fshikulluese të kritikës dhe të autokritikës para kolektivit apo në mbledhjet e partisë. Shpesh njerëzve u kërkohet një autokritikë me shkrim, pra si të thuash një aktakuzë e formuluar me dorën e tyre vetë, të cilën shteti mund ta përdorte pastaj kur t’i vinte për shtat. Këtu duhen përmendur edhe *fletë-rrufetë*, një model kinez i futur edhe në Shqipëri. Fletërrufetë u ngjanin vetëm në formë *dacibao-ve* kineze, pra të ashtuquajturave gazeta muri ku diskutohej për vijën politike. Fletë-rrufetë shqiptare, që zakonisht ishin pllakata në formë poster, ngjiteshin në këndet e fletërrufëve në sheshe publike për të ushtruar kritikë dhe autokritikë, për të demaskuar dhe spastruar përpara opinionit publik ata “elemente që ishin të huaj për natyrën e socializmit”. Në historinë e PPSH-së thuhet se fletë-rrufetë shërbenin për të çrrënjësuar “mbeturinat kapitaliste që gjenin terren të favorshëm në ndërgjegjen e njerëzve dhe që çonin në lindjen e elementeve të ndryshme antisocialiste”. Fletë-rrufetë ishin anonime dhe vetëkuptohet që me to u ishin hapur dyerë e dritare keqpërdorimeve dhe denoncimeve.

Në një shoqëri, ku sundonte detyrimi i brëndshëm i të menduarit konsekuent ideologjik dhe një skemë kryekëput e polarizuar të të menduari sipas skemës ose mik ose armik, në një shoqëri e cila nuk lejonte kurrësesi nuanca dhe klasifikime të tjera, ku polarizimi i ashpër përshkonte jo vetëm perceptimin e botës dhe të realitetit, por edhe të gjithë mendimin dhe ndjesinë, ishte i pamundur shkëmbimi i mendimeve dhe i ideve, bazuar mbi përfytyrimin e dinjitetit dhe të vlerave të njeriut.

Kjo botë përvojash që kanë grumbulluar e përjetuar shumë breza, duket se ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi mënyrën e perceptimit të jetës politike dhe publike në Shqipëri edhe tani, 20 vjet pas përmbysjes së regjimit të vjetër.

Po t’i kthehem edhe një herë tani në fund konceptit të Hannah Arendt mbi shoqërinë e kampeve të përqëndrimit, duke u mbështetur tek karakteristikat e mësipërme Shqipërinë komuniste mund ta cilësojmë në këtë mënyrë a) shteti i sundonte njerëzit në të gjitha shprehjet e jetës së tyre. Shoqëria ishte e karakterizuar nga cënimi sistematik i të drejtave të njeriut, nga një drejtimi qendror i centralizuar dhe nga kontrolli i jetës sociale e kulturore, kontrollimi i ekonomisë dhe pothuajse i të gjitha fushave të jetës. b) Shteti donte të rrafshonte çdo lloj individualiteti dhe forme të ndryshme. c) Njësoj si në kampet e përqëndrimit regjimi totalitar

në Shqipëri tentonte ta transformonte natyrën njerëzore, dhe kishte madje si synim krijimin e njeriut të ri, ose thënë ndryshe, transformimin nga njeriu si një qenie që mendon dhe vepron, në një qenie që sillet vetëm sipas reflekseve të kushtëzuara (si në rastin e qenit të Pavlovit).
d) Individët jetonin në një gjendje dyfityrësie, nga njëra anë në një gjendje gatishmëri e dhe alarmi të vazhdueshëm, ku nuk kishte kurrë prehje dhe qetësi, dhe nga ana tjetër në një kohë që dukej sikur kishte mbetur në vend dhe në kushtet e një ngushtimi ekstrem të hapësirës.

Kampet e përqëndrimit janë laboratorë për eksperimentin e sundimit total, pasi për shkak të natyrës njerëzore ky qëllim mund të arrihet vetëm në kushtet e një ferri të krijuar nga njerëzit. Sundimi total arrihet kur një qenie njerëzore, e cila është një përzjerje e mënyrave spontane dhe atyre të kushtëzuara të sjelljes, transformohet në një qenie plotësisht të kondicionuar, sjellja e së cilës mund të parashikohet, gjë që çon në vdekjen e sigurtë” – shkruante Hannah Arendt në vitin 1950 në një kumtesë me titullin “Absurdi i përkryer”.

“Gratë janë kurva. Të gjitha. Vetëm të shëmtuarat jo. Kush dërgohet në kamp apo burg duhet të jetë homo. Aitij duhet t’i thyejnë dhëmbët, ai duhet të flerë në dysHEME pa shtresa. Bukuria dhe pasuria zgjojnë dyshim, dhe dikur një herë do të ndëshkohen me deportim. Kabllot elektrike janë praktike: në “Shqipëri, ku mungonin shumë gjëra, këto silleshin me shumicë”. Në to mund të varësh tesha për t’I tharë, por edhe njerëz” – kështu shkruan Ornela Vorpsi në librin e saj me titull “Jeta e përjetëshme e shqiptarëve” botuar në vitin 2007, një libër ku përshkruhet jeta e përditëshme në Shqipërinë komuniste.

Kjo Shqipëri është një vend i dëshiruar përrallor që e gjen pasi ke kaptuar shtatë male, ku edhe pas shumë përpjekjesh nuk të ofrohet asnjë lloj shpërblimi. Përkundrazi mbretërojnë në forma të përditëshme si të ishin motra: urrejtja, poshtërimi, brutaliteti, lakmia dhe pandërgjegjshmëria. Dhe së fundi aty është edhe “nëna parti”, e cila urdhëron të rrihen, të deportohen dhe të pushkatohen fëmijët e vendit, kur këta nuk i binden asaj dhe nuk vënë dorën në zjarr për të.

Fatin e pashmangshëm të kurvës, autores ia ka parashikuar tetoja. Babai e detyron vazhdimisht ta puthë. Një ditë ai deportohet në një kamp, bile edhe miku i tij më i mirë dëshmoi kundër tij. Për shkak se ai kishte shprehur dyshimin se vitin e ardhshëm do të kishte më pak patate? Apo se një funksionar i partisë donte të flintet me nënën e bukur? Kush e di. Akuzë nuk ka asnjë. Familja e përbuz të burgosurin politik, duke e sharë atë si “pederast” dhe

duke i vënë në dukje vajzës se edhe ajo e “ka në gjak” këtë dhe se bashkë me të atin mund të ngrenë një biznes: “babë & bijë: shesim prapanicën – shërbime dashurie të të gjitha llojeve”. Ndërkohë gratë e fqinjëve vdesin gjatë një ndërprerjeje ilegale të shtatzanisë, madje edhe fëmijët e tyre nuk kanë besim te to, dhe duke pështyrë nënën e tyre të vdekur i quajnë “kurva”.

“Në Shqipëri nuk bëhet shaka. Vendi mbulohet nga pluhur e baltë, ndërsa dielli djeg në atë farë feje që edhe gjethet e hardhive digjen duke djegur dhe shkrirë edhe arsyen. Kjo ka një efekt anësor që me sa duket është i pashmangshëm: çmënduria, e cila në këtë vegetacion rritet si bari i keq. Dhe për këtë arsye këtu edhe nuk ekziston frika, për sa kohë rradakja e shtrembër dhe të sheshtë mbetet selia e indiferentizmit, dhe pse jo e mosndërgjegjes”.

Vendi i mbjellë me bunkerë të vegjël betoni është i shituar si prej një magjie arkaike. Asnjëri nuk do ta thyejë atë. Shqiptarët e duan vendlindjen e tyre – shkruan Vorpsi.

Kjo magji apo shitim me sa duket nuk do të zhbëhen për aq kohë sa shoqëria e sotme shqiptare përballet në të gjitha anët e spektrit politik dhe në të gjitha fushat me burra e gra, të cilët edhe pse ata në fakt kanë disa borxhe për të larë, përcaktojnë në pozicionet dhe postet publike me peshë që kanë fytyrën e vendit, pa u ndjerë hapur fajtorë.

Në citatin e përmëndur më sipër për përshkrimin e sundimit totalitar Hannah Arendt përdor metaforën e ferrit. Aty ajo thotë se ferri ka ekzistuar tashmë në tokë, i krijuar nga njerëzit, për njerëzit. Për pasojë ferri nuk është më një vend përtej, diku larg. Ekzistenca e ferrit në tokë nuk do të thotë se ferri është një fenomen historik, që ka marrë fund njëherë e përgjithëmonë. Ferri mund të rikthehet. Dhe që të mos ndodhë kjo, Shqipëria lipset të bëjë përpunimin e domosdoshëm, serioz dhe të shpejtë të së shkuarës, dhe të fillojë t'i përcjelljë brezi të i ri njohuritë dhe informacionet mbi diktaturën.

Përktheu nga gjermanishtja: Astrit IBRO

Shpirti dhe shteti totalitar

Dr. Pranvera Bekteshi

Për të konkretizuar temën *Shpirti dhe Shteti Totalitar*, mendoj se s'ka shembull më sinjifikativ se ai i një muzikanti të vrarë nga diktatura.

Pak kohë më parë, në fjalën e mbajtur ditën e dekorimit *Mjeshtër i Madh*, një artist shqiptar 60-vjeçar, Gazmend Mullahi, u ndal për të nderuar një artist tjetër shqiptar, ndoshta babanë e tij shpirtëror, një artist që kurrë nuk u dekorua, nuk mori ndonjë çmim, nderim apo mirënjohje. Ky ishte muzikanti Gaspër Çurçia.

Ai lindi në Shkodër në 1934 në një familje të kamur tregtarësh. Gjyshi dhe i ati ishin përfaqësues të kompanisë Ford për Shqipërinë. E ëma, Vjera, ishte kroate, prindërit e Gaspër Çurçisë ishin njohur gjatë studimeve në Zagreb.

Për të kuptuar rrethanat e formimit të këtij artisti krejtësisht të veçantë, më duhet të përshkruaj shkurtimisht qytetin e Shkodrës, qytetin ku kanë zënë fill në Shqipëri zhanret më të rralla të artit muzikor dhe jo vetëm të tij.

Shkodra - qytet i veçantë traditash dhe shpirti të lirë

Të parat vende ku është luajtur muzikë në këtë qytet, kanë qenë lokalet. Që në vitin 1878, ende nën sundimin osman, Palok Kurti me orkestrën e tij, jepte muzikë në lokalin Milet Bahçe. Aty luheshin jaret e famshme shkodrane, por edhe muzikë e huaj nga vendet fqinje. Milet Bahçe-ja frekuentohej nga qytetarët shkodranë pavarësisht fesë së cilës i përkisnin dhe kjo traditë, edhe pse me ndërpreje të herë pas herëshme, u ruajt edhe më pas ndër vite. Kleri françeskan i përkrahu përgjithësisht këto aktivitete artistike në qytet, me sa duket për të zgjuar ndjenjën kombëtare, me që ato ishin vende grumbullimi të të gjithë shqiptarëve. “*Është e pa besueshme që në Shkodër nuk u ndërpre muzika në lokale as në kohën e luftërave*”- thonë bashkëkohësit dhe njohësit e muzikës.

Pas Luftës II Botërore, në vitin 1946, në Shkodër u hap Shtëpia e Kulturës dhe Teatri. Në atë kohë bëheshin koncerte në sheshin kryesor me banda dhe orkestër. Preng Jakova ka qenë jo

vetëm iniciatori i gjithë aktivitetëve muzikore, por edhe kompozitori i operës së parë shqiptare.

Po atë vit, pra në 1946, ndodhi në Postribë, një fshat fare afër qytetit, kryengritja antikomuniste, e para e këtij lloji, jo vetëm në Shqipëri. Pas masakrës ndaj pjesmarrësve dhe familjeve të tyre, Shkodra pësoi një tronditje të madhe dhe u “tkurr”. Të asaj kohe janë shprehjet e dykuptimta të shkodranëve, shprehje që u pasuruan dhe u përdorën gjatë gjithë kohës së diktaturës: “*Shuk, a bane kursin?*”- që do të thoshte a arrestuan kënd nga familja jote?

Nën zë në gjithë Shqipërinë gjatë pothuajse pesë dekadave të diktaturës shpërndareshin barcaletat me nëntekst politik, që krijoheshin në këtë qytet njerëzish të talentuar. Ishte një nga format e revoltës ndaj pushtetit. Ato dukeshin pa autor dhe nga që kalonin gojë më gojë, i jepnin të drejtën e autorësisë të gjithë atyre që e përdornin dhe e shijonin ironinë ndaj pushtetit.

Një artist me talent të veçantë

Në këtë atmosferë Gasperi i vogël filloi të marrë mësimë muzike nga pianistja Ida Melgushi. Kjo pianiste e mbetur në hije, ka qënë mësuesja e parë e shumë artistëve të shquar nga Shkodra.

Përveç pianos ai mësoi të luante në kitarë, fizarmonikë, harmonikë, por vegla e tij e preferuar u bë trompa. Dhe me gjithë mësimet e marra, mund të thuhet se ai qe edhe autodidakt.

Për shkak të origjinës së pasur familjare Gaspër Çurçia nuk mundi të ndiqte shkollën artistike në Tiranë, por futet në lëvizjen amatore, duke interpretuar kryesisht në lokalet e qytetit. Në moshën 20-vjeçare, pas kryerjes së shërbimit ushtarak, vjen në Tiranë, me të ëmën dhe të motrën, ku edhe fejohej e më pas martohet me një vajzë tiranase. Në Tiranë gjen fillimisht punë si instrumentist nëpër lokale. Me krijimin e Estradës së Shtetit fillon për herë të parë një punë më serioze, në orkestrën e saj ku kontribuon në shumë harmonizime dhe orkestime së bashku me Alqi Karecon. Gjatë këtyre viteve ai kompozon muzikë të lehtë si dhe një muzikë për film, por kryesisht orkestronte. Incizimet e tij në radio janë ende sot shumë të arritura.

Aktiviteti i Gasprit nuk u kufizua vetëm në muzikën e lehtë. Ai arriti të studjojë, projektojë dhe të prodhojë edhe instrumenta të muzikës popullore si dhe të kompozojë për këtë orkestrë. „Por mbi të gjitha ai ishte një magjistar, një Lui Armstrong shqiptar, ishte një trombë në një gjysëm vajtim“ – sikurse shprehen kolegët e tij.

Stinë e shkurtër liberalizmi

Në vitin 1962, me fillimin e Festivaleve të Këngës në Radio Televizion, Gaspri gjeti më në fund veten në fushën e muzikës. Për herë të parë ai u bë pjestar i orkestrës së radios për festivalet e këngës. Radio Tirana transmetonte muzikë xhazi nga vendet e Lindjes si xhaz hungarez, polak çek apo gjerman edhe pas prishjes së marrëdhënieve me ish-Bashkimin Sovjetik, në vitin 1961. Po atë vit në Shqipëri filloi të ndiqet edhe televizioni italian. Shtëpitë e rralla që atë kohë e kishin këtë mundësi, pra aparat televizori, u kthyen në kinema ku ndiqeshin festivalet dhe emisionet muzikore italiane. Pak a shumë kjo situatë vazhdoi deri në vitin 1967, vitin e histerisë antikulturë, histeri që zgjati deri në vitin 1972, për t'u përsëritur edhe më ashpër në 1973.

Në vitin 1972, në arenën ndërkombëtare ndodhin ngjarje të rëndësishme. Presidenti amerikan Nikson viziton Kinën dhe shumë shpejt ky vend, satelit i të cilit qe kthyer Shqipëria që prej prishjes me Bashkimin Sovjetik, fillon të eci drejt hapjes. Kjo hapje e Kinës si dhe mundësia potenciale e rikthimit të hrushovizmit në Bashkimin Sovjetik, bëri të lindin shpresa edhe në Shqipëri. Këto shpresa mund të realizoheshin vetëm në se tek ne do të kishte një ndryshim kursit, që do të fillonte në radhë të parë në kulturë. Atë vit në fakt në të gjitha aspektet e jetës shoqërore në Shqipëri, ndjehej një frymë paksa liberale. Në të gjashtë teatrot profesioniste të vendit, u vunë në skenë drama moderne për kohën. Teatri i Operas dhe i Baletit vuri në skenë operën Traviata me një skenografi të guximshme dhe të pa përdorur më parë. Në artet figurative, me gjithë vonesën, u pranua impresionizmi dhe po bëheshin përpjekje për futjen e rrymave të më vonëshme.

Po në muzikë? Në muzikë njerëzit po prisnin me ankth Festivalin e 11-të të Këngës në RTV Shqiptar. Qenë të shumtë ata që ëndërronin si dhe që guxuan të mendonin se ky festival do të çelte rrugën e ndryshimit të kursit në politikën shqiptare. Për të flitej që më parë si për një ngjarje që do të ngrinte artin nga mediokriteti dhe vulgariteti, që kishte ozurpuar jetën kulturore-artistike të vendit.

Shumë intelektualë në fusha të ndryshme të artit dhe të kulturës kishin bërë përpjekje dhe ishin të mendimit se edhe kultura jonë duhej të hynte patjetër në rrjedhën e kulturës globale. Kjo kulturë kishte të bënte me LIRINË dhe pyetja që shtrohej me ankth ishte: A do të sillte kjo kohë disi më liberale një hap drejt saj? Koha tregoi se kjo qe e pa mundur!

Luftë shtrebrimeve dhe dekadencës – Izolimi hermetik

Më 23 dhjetor 1972 filloi Festivali i 11-të i këngës në RTSH. Për tri net ky festival u ndoq me një interes të jashtëzakonshëm, pikërisht për arsyet e përmendura më lart. Deri ditët e para të janarit 1973 kudo këndoheshin këngët e këtij festivali. Njerëzit e komentonin të gëzuar këtë ngjarje, që lidhej me shpresën për liri. Kur në mënyrë të papritur radioja dhe televizori e ndërprejnë transmetimin e këtyre këngëve dhe kudo u përhap lajmi se diktatori e kishte goditur rëndë këtë festival. Pas disa ditësh ai doli në publik dhe u shpreh: *Kjo është një muzikë dekadente që kërkon të helmojë rininë e të kryejë përmbysjen e pushtetit popullor në Shqipëri.*

Çfarë mund të pritej paskëtaj? Elita intelektuale, e veçanërisht ajo artistike, mori në shkallë të gjërë një goditje shumë të ashpër. Me qindra artistë, jo vetëm në muzikë, por edhe në fusha të tjera të artit si teatri, piktura e skulptura, morën dënime të ndryshme, deri në burgime të rënda. Kërkohej të rrafshohej gjithçka, çfarëdo progresi në art e letërsi. U pengua transmetimi i RAI-it dhe në malin e Dajtit u vendosën zhurmues. Shqipëria po mbyllej hermetikisht. Shtegu i ngushtë që ëndëronim të na çonte drejt rrugës së lirisë, u mbyll përfundimisht

Dënimi me vdekje dhe internimi i familjes

Çfarë pjese kishte Gaspër Çurçia në këtë festival? Ai ishte orkestruesi i këngëve të këtij festivali si dhe dirigjenti i parë i orkestrës së xhazit në skenë. Kjo ka qenë arritja e tij më e madhe. Ai arriti orkestrime të nivelit të lartë. Mjafton të përmendim aranzhimin në xhaz të këngës *Natën Vonë*, e cila tingëllon edhe sot e kësaj dite i kohës. Jo më kot artistët e rinj e kanë si pikë referimi.

Por si të gjithë organizatorët dhe kontribuesit e këtij festivali, që mbeti në historinë e muzikës, të jetës artistike dhe shoqërore-politike të Shqipërisë, edhe ai mori dënimin përkatës. Gasperi u

çua fillimisht puntor në ndërmarjen *Migjeni*. Pas disa vitesh edhe aty filloi pas orarit, punën e muzikantit në lëvizjen amatore, duke organizuar një grup xhazi vetëm me femra.

Në vitin 1978 Gaspri punon në një ndërmarje tjetër, i angazhuar këtë radhë me prodhimin e instrumentave popullore, të cilat i projektonte dhe ndërtonte me pajisjet e ideuara prej atij vetë. Mendja e tij e jashtëzakonëshme nuk rresht së krijuari, deri sa në vitin 1984 akuzohet për një krijim të një lloji të veçantë, i cili kurrë nuk u provua, por që i kushtoi atij jetën.

E gjithë veprimtaria e tij artistike u ndalua rreptësisht dhe u asgjësua. Më 11 prill të vitit 1984 muzikanti i shquar, Gaspër Çurçia, ekzekutohet pas dhënies së dënimit kapital. Në të njëjtën ditë, një vit më pas u “shpall” vdekja e diktatorit shqiptar Enver Hoxha, i cili ideoi, frymëzoi dhe vuri në jetë jo vetëm ekzekutimet e kundërshtarëve të tij politikë realë apo imagjinarë, por edhe të të gjithë shqiptarëve që luftuan për sado pak liri në fushat ku ata kontribuan, pra edhe në art.

Lajmi i pushkatimit të Gasprit, megjithëse i pashpallur, u përhap fshehurazi në botën artistike të Tiranës. Qe një zi në heshtje. Pas vrasjes së artistit fillon kalvari i familjes së tij: Po atë vit, gruaja Vasilika dhe tre djemtë e tij Marku, Eduardi (Edi) dhe Fredi, internohen në fshatin Dardhë të Beratit, në një zonë të thellë malore.

Marku kishte trashëguar duart e arta të të atit, Fredi pasionin për trompë, kurse Edi, mirësinë e tij. E fejuara e Edit, Zana, pa marrë parasysh pasojat dhe vështirësitë e jetës në internim, i bashkohet familjes Çurçia në fshatin Dardhë. Gjatë viteve të hidhura të internimit familja pati edhe një gëzim të madh, lindjen e dy fëmijëve, Vjerës dhe Xhinos.

Kalvari i mundimeve pas internimit

Në vitin 1991, familja Çurçia, si shumë familje të tjera të dënuara, kthehet në Tiranë dhe vendoset në ndërtesën e ish-Shkollës së Partisë. Tani fillon për ta një fazë tjetër jete në mizerabilitet: Regjimi i vjetër po lëshonte terren, sepse s'mund ta mbante më. Shkolla e Partisë, si bastion ideologjik i rëndësishëm i sistemit komunist, ishte nga të parat objekte, që u ‘pushtuan’.

Të gjitha ambientet e kësaj shkolle u populluan me ish të dënuar politikë, por kryesisht me të dënuar ordinerë të liruar atë vit nga burgjet. Kush ka jetuar apo vizituar ato vite territorin e asaj shkolle, mund ta dijë se ajo u kthye në një farë getoje, mu afër qendrës së kryeqytetit shqiptar.

Familja Çurçia u sistemua në një hapësirë, që më parë kishte shërbyer si kafe e shkollës. Hapësira kishte një parket që u kalb në mënyrë të rrufeshme, por së paku kishte një çati, edhe pse pikonte. Në cepin tjetër të katit të parë u sistemua një familje e ardhur edhe ajo nga internimi dhe burgjet politike. Ambienti që ata zunë kishte shërbyer më parë si infermjeri e më pas si depo. Ish-kafeneja dhe ish-depoja, u bënë për vite vendet ku dy familjet kalonin çaste të gëzuara në liri, edhe pse në mes të varfërisë dhe mungesës së kushteve më elementare të higjienës. Në dhomën e vetme e të madhe të Çurçive një prej djemve „të depos“, festoi dasmën e tij. Tradita e vjetër e familjes u shfaq edhe në këto kushte banimi.

Me lejoni t'i përshkruaj paksa këto kushte banimi, megjithëse nuk do të jetë aspak e këndëshme për lexuesin. Disa qindra njerëz të kthyer nga burgjet dhe internimet, jetonin të ngucur në katër apo pesë godinat e shkollës, çdo familje në një apo dy dhoma konvikti. Për çdo kat kishte tri apo katër të ndara banjash alla turka dhe asnjë vend për të bërë dush. Nga banorët e shumtë banjat bllokoheshin çdo javë duke filtruar më pas në tavanet e kateve të më poshtëm. Plehurat e hedhura nga penxheret krijonin pirqje që zinin dritën dhe ajrin e penxhereve të katit të parë që që ngjitur me tokën, kat i cili sulmohej edhe nga „banorët“ e tjerë të kësaj shkolle: Ata ishin më të shumtë në numër se banorët e sapo ardhur, dhe të llojeve të ndryshme. Ishin minj gjirizesh të mëdhenj, minj banesash të veckël, krimba shumëkëmbësh të shumuar nga lagështira e madhe, krimba me bisht që s'njihnin pengesa, bubureca, tartabiqe, akrepë dhe merimanga të madhësive të ndryshme, mushkonja dhe miza që nuk njihnin stinë.

Në këtë mjedis u rritën Vjera dhe Xhinua i vogël me prindër thuajse pa punë. Për më tepër Vasilika, gjyshja e tyre, një grua me një mirësi të jashtëzakonëshme, një mësuese shumë e dashur për breza të tërë nxënësish, sëmuret rëndë dhe pas një vuajtje të madhe, ndahet nga jeta.

Vëllai i vogël Fredi i ikur në Itali, nuk mund të vijë për të varrosur nënën, sepse humbet të drejtën e kthimit. Dëshpërimi rikthehet përsëri në familje.

Megjithëatë Edi dhe Zana me shumë përpjekje, gjejnë mënyra të ndryshme mbijetese duke realizuar me shumë vështirësi shkollimin e Vjerës së talentuar. Dhe atë që nuk realizuan dot djemtë e Gasprit, e realizoi mbesa e tij. Ajo ndoqi traditën artistike të familjes, studjoi dhe u diplomua në shkollën e baletit dhe sot është soliste në Ansamblin e Këngëve dhe Valleve.

Xhinoja ndodhet në Itali, ku punon dhe ndihmon prindërit që janë pa punë fikse dhe që jetojnë edhe sot atje, ku për fat të keq kushtet e jetesës kanë ndryshuar shumë pak dhe ku ende është aktuale elegjia që i thuren kësaj shkolle nostalgjikët e komunizmit: Moj Shkoll e Partisë / Ç'të ka rënë zija / Varur nëpër tela rroba vija –vija / Atje ku marksizmi mësohej më parë / Sot venë e vijnë vetëm të paparë.

Përballja me të kaluarën dhe hapja apo mbyllja e dosjeve në Shqipërinë postkomuniste

Artan Puto

Një nga ligjet më të debatueshme në Shqipërinë paskomuniste, dhe gjithashtu edhe më të rëndësishme, ka qënë ai që do të përcaktonte qëndrimin ndaj shtetit totalitar komunist dhe në veçanti ndaj shkeljeve të tija masive të të drejtave të njeriut.

Ligji i parë ka hyrë në fuqi më 26.09.1995, me nr. 8001. Ky ligj emërtohej “Për genocidin dhe krimet kundër njerëzimit kryer në Shqipëri, gjatë sundimit komunist për motive politike, ideologjike dhe fetare”. Ligji mbështetej në dispozitat kryesore kushtetuese dhe në nenet e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Ligji në fjalë, siç shprehet ai në preambulën e tij, kishte si synim që të “përsheptonte çështjet penale që lidhen me krimet kundër njerëzimit për motive politike, ideologjike, klasore dhe fetare, organizuar dhe kryer nga shteti komunist në kundërshtim me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, nëpërmjet dhunës fizike e psikike, montimit, falsifikimit ose manipulimit të të dhënave, duke sjellë për pasojë vrasjen, burgosjen, internimin dhe dëbimin, si dhe rrënimin masiv të institucioneve dhe objekteve të kultit”.

Objekti i ligjit formulohet në nenin 3 të tij si më poshtë “nuk mund të zgjidhen paskëtaj në organet qendrore dhe lokale të pushtetit dhe as të emërohen në administratën e lartë të shtetit, në sistemin gjyqësor dhe në masmedia, deri më 31.12.2001, autorët, ideatorët dhe zbatuesit e krimeve të mësipërme, që kanë qënë deri më 31 mars 1991: ish-anëtarë të Byrosë Politike dhe të Komitetit Qëndror të PPSH (dhe PKSH), ish-ministra dhe ish-deputetë të Kuvendit Popullor, ish-anëtarë të Këshillit Presidential, ish-kryetarët e Gjykatës së Lartë, ish-Prokurorët e Përgjithshëm, ish-sekretarë të parë të rretheve, ish-punonjës të Sigurimit të Shtetit, ish-bashkëpunëtorë të Sigurimit të Shtetit si dhe denoncuesit dëshmitarë në dëm të të pandehurve në proceset politike, me përjashtim të rasteve kur kanë vepruar kundër vijës zyrtare dhe janë larguar vetë në mënyrë publike”.

Më 30.11.1995 del një ligj tjetër me nr. 8043 që emërtohej “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik”. Synimi i tij ishte që të kontrolloheshin “Organet dhe funksionet për të cilat ky ligj përcakton kushtet për të shërbyer në to”, dhe këto ishin:

- a) deputetët, b) Presidenti i Republikës, c) anëtarë të qeverisë, d) sekretarë shteti, zëvendës të tyre, drejtorë të përgjithshëm, ç) në presidencë, në administratën e Kuvendit Popullor dhe të Këshillit të Ministrave, të ministrive dhe të institucioneve të tjera qëndrore, dh) guvernatorë, zv/guvernatorë dhe drejtorët e BSH, d) në forcat e armatosura të Republikës së Shqipërisë, (gjeneral, kolonel), e) prefektët, kryetarët e bashkive, f) SHIK, Shërbimi Informativ Ushtarak (SHIU) dhe Shërbimi Informativ i Rendit (SHIR), g) në Gardën e Republikës, h) Shefa të Komisarariatit, shefa të policisë, punonjës të policisë kriminale, i) gjyqtarë, j) në trupin diplomatik, k) në RTSH, në ATSH si drejtues dhe redaktorë, l) gazetarë dhe punonjës me detyrë të lartë në gazetat me tirazh mbi 3.000 kopje, m) në funksione drejtuese në bashkësitë ekonomike, në institucionet shtetërore financiare, n) rektor ose drejtor në universitet apo shkolla të larta.

Neni 2 përcaktonte që për të shërbyer në këto funksione duhet që personi gjatë periudhës 28.11.1944 deri më 31.03.1991: a) të mos ketë qënë anëtar ose kandidat i Byrosë Politike, anëtar i Komitetit Qendror, sekretar i parë në rrethe, me përjashtim të rasteve kur ka vepruar kundër vijës zyrtare, ose është larguar vetë në mënyrë publike, b) të mos ketë qënë anëtar qeverie, anëtar i Këshillit Presidencial, kryetar i Gjykatës së Lartë, prokuror i përgjithshëm, deputet para zgjedhjeve të 31 marsit 1991, me përjashtim të rasteve kur ka vepruar kundër vijës zyrtare ose është larguar vetë në mënyrë publike, c) të mos ketë qënë në Sigurim, d) të mos ketë qënë i regjistruar në materialet e Sigurimit të Shtetit si bashkëpunëtor, e) të mos ketë qënë denoncues, dëshmitar i rremë ose rëndues në procese politike në dëm të të pandehurit, f) të mos ketë mbaruar Shkollën e Lartë të Ministrisë së Brëndshme, h) të mos ketë marrë pjesë si hetues, prokuror, gjyqtar a ndihmës gjyqtar në procese politike, i) të mos ketë qënë bashkëpunëtor i ndonjë shërbimi të huaj.

Më vonë Kuvendi i Shqipërisë me një ligj nr. 8219, dt.13.05.1997 i bën disa ndryshime ligjit nr.8001 për genocidin. Ndryshimi është si vijon:

“Nuk mund të zgjidhen paskëtaj deputetë në Kuvendin Popullor dhe kryetarë bashkie dhe as të emërohen në administratën e lartë të shtetit, në sistemin gjyqësor dhe në masmedia, deri në 31.12.2001 autorët, ideatorët dhe zbatuesit e krimeve të mësipërme që kanë qënë

ish anëtarë të Byrosë Politike, ish-punonjës të Sigurimit të Shtetit, ish bashkëpunëtorë të Sigurimit të Shtetit, denonclesit dëshmitarë në dëm të të pandehurit në proceset politike, me përjashtim të rasteve kur kanë vepruar kundër vijës zyrtare dhe janë larguar vetë në mënyrë publike, si dhe personat e dënuar me vendim të gjykatës për krime kundër njerëzimit. Ish-bashkëpunëtorët e Sigurimit të Shtetit, si dhe denonclesit dëshmitarë në dëm të të pandehurve në proceset politike përjashtohen nga ky rregull edhe në rast se nuk e kanë ushtruar më veprimtarinë në 20 vitet e fundit”.

Ndryshimet e ligjit 8001 synojnë:

- a) të ngushtohet rrezja e veprimit, nuk përfshihen më “organet lokale dhe qendrore”, por lihet vetëm “kryetar bashkie”; po ashtu nuk përfshihen më “ish-ministra”, “ish deputetë”
- b) të shënohet një ashpërsim në dimensionin kohor shtohet “ish-bashkëpunëtorët e Sigurimit të Shtetit edhe në rast se nuk e kanë ushtruar më veprimtarinë në 20 vitet e fundit”.

Ndryshimi dytë i ligjit 8001 për “gjenocidin” shënohet në dt.09.08.1997, me ligjin nr.8231 dhe ka vetëm një nen. Ndryshimi ka të bëjë me nenin 3 në paragrafin e parë hiqen fjalët “zgjidhen paskëtaj deputetë në Kuvendin Popullor dhe kryetarë bashkie”.

Më 30 tetor të vitit 2006 kemi miratimin e Rezolutës së Kuvendit Popullor “Për dënimin e krimeve të kryera nga regjimi komunist në Shqipëri”. Kuvendi i Shqipërisë u referohet Rezolutave të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, nr.1096 (1996) “Masat për të çrrënjësuar trashëgiminë e sistemeve totalitare komuniste”, si dhe vendimeve të Konventës së Parë Kombëtare të Shoqatës Mbarëkombëtare për Integrimin e të Përndjekurve Politikë dhe Qendrës Shqiptare të Rehabilitimit të të Mbijetuarve të Torturës “Për dënimin e krimeve të komunizmit në Shqipëri”, dt.12.05.2006.

Pika 2 e nenit është një përkthim i regjimit totalitar shqiptar që karakterizohet nga “dhunimi masiv i të drejtave të njeriut.

Pika 3 thotë se “partitë që juridikisht trashëguan strukturat, anëtarësinë dhe pronat e PPSH-së, nuk kanë shprehur deri sot vullnetin për t’u distancuar nga regjimi totalitar komunist, nga “lufta e klasave” dhe “diktatura e proletariatit”, si dhe krimet e Enver Hoxhës dhe klikës së tij”.

Pika 4 kujton se “autorët nuk janë dënuar dhe nuk kanë kërkuar falje publike viktimave të genocidit komunist.

Pika 5, një tipar i ri i rezolutës së tanishme në krahasim me ligjet e mëparshme të “genocidit” është, se vihet theksi mbi ndërgjegjësimin e brezit të ri mbi krimet nga regjimi diktatorial i Enver Hoxhës.

Pika 6 përmban gjithashtu disa risi në krahasim me legjislacionin e kaluar, sepse Kuvendi i Shqipërisë “shpreh bindjen se njohja dhe denoncimi i krimeve të diktaturës komuniste i shërben shmangjes së përsëritjes së krimeve të kryera dhe rivlerësimi real i historisë luan një rol të rëndësishëm në edukimin e brezave të rinj”.

Pika 7 Kuvendi i Shqipërisë dënon fuqimisht dhunimet masive të të drejtave të njeriut.

Pika 8 Kuvendi i Shqipërisë dënon diktatorin Enver Hoxha si ideatorin, frymëzuesin, drejtuesin dhe ekzekutuesin e sistemit më të egër diktatorial komunist në Evropën Lindore që çoi në izolimin dhe varfërimin e Shqipërisë dhe kërkon heqjen e të gjithë titujve dhe dekoratave të dhëna atij e bashkëpunëtorëve të tij nga regjimi komunist.

Pika 9 Kuvendi i Shqipërisë kërkon rishikimin e datave simbol të sistemit komunist, që shënojnë instalimin e diktaturës komuniste në Shqipëri.

Pika 10 Kuvendi i Shqipërisë kërkon bërjen publike të të gjitha dokumenteve që dëshmojnë krimet e regjimit komunist përfshirë edhe dosjet e krijuara në ish-institucionet e përndjekjes dhe të dënimeve politike si Sigurimi i Shtetit, Prokuroritë, Gjykatat dhe Komitetet e Dëbim-Internimeve .

Pika 11 Kuvendi i Shqipërisë kërkon hapjen e dosjeve të ish-bashkëpunëtorëve të Sigurimit të Shtetit për politikanët, drejtuesit e institucioneve kushtetuese, atyre të sistemit të drejtësisë, të administratës publike qendrore e lokale, si dhe të mediave kombëtare audio-vizive apo të shkruara.

Pika 12 Kuvendi i Shqipërisë fton partitë komuniste dhe post-komuniste në Shqipëri, që të rikonsiderojnë historinë e komunizmit dhe të kaluarën e tyre, të distancohen qartësisht nga krimet e kryera nga regjimi komunist dhe nga diktatori Enver Hoxha, duke i dënuar ato pa asnjë mëdyshje.

Pika 13 Kuvendi i Shqipërisë fton akademikët, historianët dhe ekspertët e pavarur që t'i intensifikojnë kërkimet e tyre për përcaktimin dhe verifikimin objektiv të historisë së Shqipërisë gjatë diktaturës komuniste.

Pika 14 Kuvendi respekton dhe shpreh mirënjohje për viktimat e regjimit totalitar.

Pika 15 Kuvendi i Shqipërisë mbështet hartimin e një strategjie kombëtare për eliminimin e pasojave të totalitarizmit gjysmëshekullor në Shqipëri dhe fton institucionet shtetërore të

përbushin të gjitha detyrimet ligjore lidhur me statusin e të përndjekurve politikë për integrimin, arsimimin, punësimin, strehimin dhe dëmshpërblimin e tyre në një kohë sa më të shpejtë, si dhe akordimin e një fondi për gjetjen e të zhdukurve dhe të vararëve me apo pa gjyq për arsye politike.

Pika 16 Kuvendi i Shqipërisë nxit fillimin e një fushate kombëtare për ndërgjegjësimin rreth krimeve të kryera në emër të ideologjisë komuniste duke përfshirë rishikimin e librave shkollorë, shpalljen e një dite kombëtare për përkujtimin e viktimave të komunizmit, hapjen e muzeumeve, përfshirë edhe kthimin në muze të burgjeve politike, si dhe ngritjen e memorialeve në nderim të shqiptarëve që u vranë për kundërvënien ndaj regjimit totalitar.

Pika 17 Kuvendi i Shqipërisë mbështet organizimin e një konference kombëtare me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të parlamentit, qeverisë, partive politike, shoqatave të të persekutuarve, akademikëve, historianëve si dhe ekspertëve të OJQ-ve, për krimet e kryera nga regjimet totalitare komuniste.

Disa vërejtje të përgjithshme për rastin shqiptar

- 1) Në radhë të parë të bie në sy manipulimi politik që i bëhet këtij problemi kaq të rëndësishëm dhe kompleks social e moral. Kjo është e vlefshme për të dyja krahët e politikës shqiptare.
 - a) Kjo vihet re në kohën e shpalljes së tyre. Ato janë miratuar kryesisht disa muaj para zgjedhjeve, për të favorizuar partinë në fuqi, ose të ndryshuar disa kohë pas zgjedhjeve nga partia që vjen në fuqi.
 - b) Vihet re se këto ligje përdoren edhe, nëse do të shpreheshim me gjuhën e futbollit, si në sulm dhe në mbrojtje. Partitë e djathta, duke i konsideruar partitë e majta si trashëgimtare të PPSH-së, ndonëse në partitë e djathta ka edhe ish-anëtarë dhe funksionarë të PPSH-së. Ndërsa partitë e majta mbrohen duke ngushtuar rrezën e veprimit të ligjit, siç është rasti i ndryshimeve që i bëhen ligjit për “genocidin” në gusht 1997. Sapo këto të fundit vijnë në pushtet hiqen kufizimet për zgjedhjen e deputetëve dhe të kryetarëve të bashkive.
- 2) Ka një ndryshim midis natyrës së ligjeve dhe rezolutës së miratuar rishtazi. Ligjet nga ana e tyre kanë pasur më tepër funksion ndëshkues. Në këtë rast referimi është i qartë kur përmendet Kodi penal. Ndërsa rezoluta e 2006 mbështetet te Rezoluta e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Rezoluta 1096 (1996) “Masat për të çrrënjësuar trashëgiminë e sistemeve totalitare komuniste”, Rezolutës 1481 (2006),

“Domosdoshmëria për dënimin ndërkombëtar të krimeve të regjimeve totalitare komuniste”.

- 3) Ka edhe një paqartësi në përdorimin e termit “genocid”. Ndoshta qëllimi ka qënë që të goditej dhe të bënte më tepër përshtypje nocioni i dhunimit të të drejtave në mënyrë masive.

Hapja e dosjeve

Në gjykimin tim hapja e të gjithave dosjeve është thjesht një manipulim që bëhet për të instrumentalizuar mendjet e njerëzve. Arsyet e këtij pohimi unë i mbështes në disa vlerësime. Do të isha i interesuar që në lidhje me këtë pikë të kishte sa më shumë debat dhe kundërvënie opinionesh.

- 1) Për mua një nga arsyet kryesore që dosjet nuk mund të hapen masivisht në Shqipëri është mungesa e një konsensusi politik midis partive të mëdha dhe fakti i thjeshtë nëse ato ekzistojnë ende apo jo. Ndërtimi i një memorie kolektive për një periudhë të caktuar historike, në rastin tonë periudha e regjimit totalitar komunist, kërkon një lloj konsensusi që ai mos të përdoret politikisht. Kontributi më i madh që mund të japë politika në përballjen me të kaluarën është jo ajo që synohet të paraqitet si e kaluara e një shoqërie, por mënyra se si merren këto vendime në lidhje me të kaluarën. Në njëfarë mënyre ligjet luajnë një rol të madh në atë që do të kujtojë shoqëria; ligjet mund të shkojnë drejt harresës në regjime represive, ose mund ta mbajnë gjallë kujtesën dhe të kultivojnë një kulturë të përkujtimit. Por, në këtë pikë një rëndësi të madhe marrin format dhe procedurat që përdoren për të realizuar procesin e përkujtimit. Ligjet duhet të çojnë drejt ndëshkimit të autorëve të krimeve jo nëpërmjet furisë revolucionare dhe hakmarrjes. Të tëra këto ligje të rëndësishme kërkojnë që legjislatura t’i marrë këto vendime jo me një shumicë të thjeshtë, por me një mbështetje të gjerë, dhe këto vendime të vijnë pas një procesi diskutimi politik dhe transparent.

Në përballjen me të kaluarën, mendoj se kontributi më i madh që mund të japin ligjet janë format dhe procedurat që ato përcaktojnë, të cilat në radhë të parë duhet të jenë transparente dhe jo të lidhura me interesat e politikës së ditës. Ky është jo vetëm një kontribut i rëndësishëm për sa i përket përballjes me të kaluarën, por edhe për kulturën politike në përgjithësi.

- 2) Çështja e dosjeve është një çështje madhore me pasoja shumë të rënda sociale dhe për këtë arsye ky proces duhet të ketë patjetër një mbështetje të fortë politike nga të gjitha krahët. Por, për pothuajse të gjitha temat e rëndësishme të vendit të dy partitë kryesore shqiptare, Partia Demokratike dhe Partia Socialiste, nuk kanë rënë asnjëherë në një mendje. Në këtë pikë ka qënë faktori ndërkombëtar ai që e ka shpëtuar situatën. Ndër pikat më të rëndësishme mund të përmendnim kushtetutën, të cilën partia që është në pushtet nuk e ka njohur dhe në kohën e vet e ka quajtur si një kushtetutë të ideologjizuar. Ndërsa sot flet në emër të kushtetutës. Nuk ka një konsensus për festën kombëtare, datën e çlirimit të vendit, nuk ka një konsensus për marrëdhëniet pronësore mbi tokën, që është një nga kushtet kryesore për të zhvilluar një ekonomi tregu jo të deformuar, nuk ka konsensus për zgjedhjet, etj. Shpesh çështje të tilla keqpërdoren nga partitë në pushtet, dhe në këtë sens mund të themi se partitë e djathta kanë bërë pak po të kemi parasysh që ato identifikohen me shtresën e të persekutuarve të regjimit totalitar. Ndërsa partitë e majta nuk kanë guxuar ta dënojnë hapur atë kohë sepse kanë frikë nga rrjedhja e elektoratit.
- 3) Kriza e besimit tek institucionet e shtetit është një tjetër faktor me peshë që e pengon seriozisht këtë proces. Kush do ta bënte dhe do të mbikqyrte procesin e hapjes së dosjeve? Cili është ai autoritet moral, ose ai organ që të pranohet nga të dyja palët e politikës shqiptare për të shpënë në fund këtë ndërmarrje? Sistemi gjyqësor është në mënyrë të vazhdueshme në vendet e para të *hit paradës* së korrupsionit. Të gjithë e dimë sesi punojnë gjykatat shqiptare. Nëse do të kishte abuzime me hapjen e dosjeve dhe dikush do të ankohej në gjykatë, cila do të ishte garancia e marrjes së një vendimi të drejtë, kur rëndom ndodh që marrëdhëniet gjyqtar-avokat janë para së gjithash marrëdhënie biznesi.
- 4) Mungesa e institucioneve të pavarura. Një nga shtyllat e një sistemi demokratik janë edhe ndarja e pushteteve. Në Shqipëri sa herë ndërrohet pushteti, ndërrohet edhe administrata shtetërore, por mbi të gjitha gjithmonë tentohet që të vihet nën kontroll pushteti gjyqësor. Kjo ka ndodhur në vitin 1997, kjo ka ndodhur edhe tani.
- 5) Mungesa e dëmshpërblimit në një masë të kënaqshme për këtë shtresë. Nuk duhet mohuar ajo që është bërë, por të gjithë e dimë se përsëri kjo shtresë mbetet ende e marginalizuar. Unë mendoj se një dëmshpërblim i drejtë dhe i arsyeshëm do të bënte që shteti të njihte zyrtarisht vuajtjet dhe persekutimet duke krijuar një klimë më të favorshme për një proces rehabilitimi dhe paqeje sociale.

- 6) Unë mendoj se dosjet mund të hapeshin vetëm për politikanët dhe postet e larta të administratës shtetërore. Kjo për arsyen se një person me të një të kaluar të komprometuar nuk mund të marrë përsipër detyra publike ose të veprojë në emër të një komuniteti. Do të kishim të bënim me një krizë morale dhe krizë të përfaqësimit.

Fondacioni Konrad-Adenauer (KAS) është një fondacion politik, i afërt me partinë Unioni Kristian-Demokrat i Gjermanisë (CDU). Fondacioni drejtohet në veprimtarinë e tij nga parimet e lirisë, të drejtësisë dhe të solidaritetit. Fondacioni mban emrin e Konrad Adenauerit (1876-1967), i cili ishte edhe bashkëthemelues i Unionit Kristian-Demokrat dhe si kancelari i parë i Republikës Federale të Gjermanisë dhe bashkoi në një traditat kristiane me ato sociale, konservatore dhe liberale. Emri i tij është simbol për rindërtimin demokratik të Gjermanisë, për pozicionimin e politikave të saj të jashtme në një bashkësi vlerash transatlantike, për vizionin e një Evrope të bashkuar dhe për orientimin ndaj ekonomisë sociale të tregut. Trashëgimia e tij shpirtërore është për ne, detyrë dhe zotim njëkohësisht.

Në Shqipëri Fondacioni Konrad-Adenauer fondacioni punon në partneritet me institucionet shtetërore, me partitë si dhe me organizatat e shoqërisë civile. Fondacioni KAS – Zyra për Shqipërinë, vë në jetë projekte me parlamentarë, akademikë, njerëz dhe aktorë të shtetit të së drejtës, për të arritur kështu përmbushjen e kushteve të anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

Shqyrtimi i së kaluarës së hidhur komuniste është një nga fushat e analizave të KAS, sepse në këtë mënyrë mund të forcohen më shumë themelet e shtetit të së drejtës dhe të kontribuohet për një shoqëri më të drejtë.



OJQ-ja **CEAPALNET** synon përmes veprimtarive të veta të nxisë një shoqëri të përgjegjshme, të informuar dhe të angazhuar ndaj parimeve demokratike si dhe të inkurajojë qytetarët të përfshihen në mënyrë aktive në politikë duke forcuar qëndrimet demokratike dhe mekanizmat për dialog dhe parandalimin e konflikteve.

CEAPALNET angazhohet në sektorë të ndryshëm të shoqërisë dhe në veçanti tek profesionistët e rinj, intelektualët, politikanët, akademikët, gazetarët, juristët, minoritetet dhe aktivistët e shoqërisë civile.

Përmes programit “**Laboratori i Përbaljes me Historinë**” CEAPALNET synon të nxisë një qasje të re në interpretimin e historisë së Shqipërisë, në mënyrë të veçantë ndaj periudhës së regjimit totalitar komunist duke inkurajuar zbatimin rigoroz të standardeve profesionale dhe etike.